



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MAJTUR MË
14 MARS 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 14. MARTA 2008.
GODINE**

**Mars – Mart
2008**

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 26, 27, 28 e 29 shkurt dhe më 3 mars 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2007,
4. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave,
5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale e Media dhe të Komisionit Parlamentar ad hoc lidhur me emërimin e dy anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

D n e v n i r e d:

1. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice od 26, 27, 28, i 29. februara i 3. marta 2008. godine,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Razmatranje Izveštaja Regulatorne komisije za javne nabavke za 2007. godinu,
4. Razmatranje Predloga Vlade za izbor članova Komisije za popis stanovništva, domaćinstava i stanova,
5. Razmatranje Predloga Vlade za izbor direktora Centralnog bankarskog autoriteta Republike Kosova,
6. Razmatranje Preporuke Komisije za javne službe, lokalnu upravu i medije i ad hoc Parlamentarne komisije za imenovanje dva člana u Odboru Samostalne komisije za medije.

A g e n d a:

1. Approval of the minutes of the plenary sessions of 26, 27, 28 and 29 February and 3 March 2008,
2. Time for parliamentary questions,
3. Discussion of the report of the Regulatory Committee of Public Procurement for year 2007,
4. Discussion of the proposal of the Government in selecting members of the Central Committee for registration of the population, family economy and apartments,
5. Discussion of the proposal of the Government for selection of the Central Banking Authority of Republic of Kosovo,
6. Discussion of the recommendation of the Committee for Public Services, Local Administration and Media and of Ad Hoc Parliamentary Committee regarding the appointment of two members of the Council to the Independent Media Commission.

T R A N S K R I P T
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MAJTUR MË
14 MARS 2008

Seanca filloi punën në orën 10,00.

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit Qeveritar,
Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 94 deputetë, që do thotë se janë plotësuar të gjitha kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendin e ditës e keni marrë së bashku me materialet që u janë shpërndarë deputetëve, prandaj fillojmë me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 26, 27, 28, 29 shkurt dhe më 3 mars 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura, më 26, 27, 28, 29 shkurt dhe 3 mars 2008, si dhe transkriptet nga këto seanca, iu janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbalet e seancave të lartpërmendura?

Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam një vërejtje. Është përvjedhur një gabim në faqen 55, në fjalinë e tretë, te fjalët që i kam thënë. Në vend të fjalëve që janë shënuar këtu, është dashur të jetë: "gabime gjuhësore", kurse këtu ka dalë: "gabime gjyqësore". Domethënë, është ndryshuar përmbajtja e fjalëve të mia. Ju lus, të përmirësohet ky gabim.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka vërejtje të tjera në transkript? Nuk ka.

Lus administratën ta bëjë korrigjimin e kërkuar.

Pasi nuk ka vërejtje të tjera, e hedh në votim miratimin e procesverbalit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 83 vota “për”, 1 abstenim, miratohet procesverbali. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Koha për pyetjet parlamentare

Ju njoftoj, se në pajtim me Rregullën 26 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e përcaktuar me Rregullore, sipas radhës, janë parashtruar këto pyetje parlamentare:

Pyetja e parë është bërë nga deputeti Nait Hasani – PDK, për ministren e Drejtësisë Nekibe Kelmendi.

Lus deputetin, ta lexojë pyetjen.

NAIT HASANI: Unë kam parashtruar pyetjen, si vijon: Në burgjet e Kosovës gjenden disa grupe të gjykuara, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me nga 4 e 5 vjet burg, të cilët që sa vite janë në burg me gjykime jo të plotfuqishme. Ata janë trajtuar në mënyrë të ndryshme dhe gjykimet e tyre janë politike. Unë mendoj se këto raste, si rastet “e Kiçinës”, “Grupi i Rahovecit”, “Grupi i Kaçanikut”, “Shefqet Musliut” duhet të trajtohen me urgjencë dhe të merret vendim për trajtimin e këtyre lëndëve dhe lirin e tyre.

Pyetja është: Kur mendoni, zonja ministre, që këto lëndë t’i shqyrtoni dhe a ka ndonjë afat kohor që mund të shpresojmë se do të vendosni për këto lëndë? Pra, po të ishit ju në pozitë të tyre nëpër burgje, me siguri se do të ankohehit kësajsoj.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministrja e Drejtësisë, zonja Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kolegë deputetë,

Në këtë rast paraqitem në cilësinë e ministres së Drejtësisë, megjithatë, nuk e kam humbur kolegjalitetin me ju.

Lidhur me pyetjen e shtruar nga deputeti, zoti Nait Hasani, unë kam këtë përgjigje:

Sipas Rregullores së UNMIK-ut, numër 2005/52, datë 20.12.2005, kompetent për punët e Gjyqësorit është Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës.

Meqë pyetja juaj lidhet me veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor Prokurorial të Kosovës, por, pjesërisht edhe me Departamentin e Drejtësisë, të drejtuar nga UNMIK-u, unë nuk jam kompetente të përzihem në punën e Gjyqësorit. Megjithatë, për hir të ruajtjes së qetësisë në Burgun e Dubravës, i jam drejtuar me shkrim drejtorit të Departamentit të Drejtësisë dhe kam kërkuar nga ai që të ndërmarrë masa lidhur me vonesat përkitazi me përshpejtimin e procedurave të gjyqimit dhe të hartimit të aktgjykimeve, në mënyrë që të zbatohet në tërësi Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e cila parashikon gjykim brenda afati të arsyeshëm dhe gjykim fer.

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! A ka pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Nëse, vërtet, Gjyqësori e ka të drejtën dhe nuk merr masa dhe vonohet me nga 4-5 vjet, kush do të jetë përgjegjës dhe kush do ta gjykojë, do ta angazhojë ose shkarkojë Gjyqësorin? Nëse ekzekutivi nuk e merr vendimin, kush do ta bëjë këtë?

KRYETARI: Fjalën e ka ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Ekziston pranë Këshillit Gjyqësor Prokurorial Njësia për hetuesinë e punës së gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe ajo ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë, që mund të ndërmarrë masa disiplinore nëse ka vend për të marrë masa të tilla. Kurse, sa u përket gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë ata gëzojnë një imunitet dhe nuk mund të ndërmerren masa nga ana e Këshillit Gjyqësor e Prokurorial.

Mua më vjen shumë keq dhe unë e di se kjo gjë nuk është në rregull, por nuk është në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë.

KRYETARI: Me kaq përfundoi edhe pyetja shtesë dhe u dha edhe përgjigja. Vazhdojmë më tutje.

Pyetja e dytë e deputetit Riza Smaka – nga Partia AKR, i është bërë ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj, por ai mungon. Kjo pyetje është lexuar javën e kaluar dhe do të botohet në Buletinin e Kuvendit.

Kalojmë në pyetjen e tretë që e ka parashtruar deputeti Zafir Berisha nga PDK-ja, e cila ka të bëjë me ministren e Energjetikës dhe të Minierave, Justina Pula.

Lus deputetin ta lexojë pyetjen.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqë ne jemi duke kaluar një gjendje të rëndë energjetike, kam menduar se, megjithatë, edhe në këtë forum duhet të diskutohet dhe mundësisht edhe nga zonja ministre të jepet, ndoshta, edhe një përgjigje strategjike se si duhet t'ia dalim kësaj çështjeje. Unë e kam shtruar çështjen kësisoj.

Gjendja e rëndë energjetike në Kosovë që nga viti 1999 po bëhet edhe më e padurueshme, pas pavarësisë së Kosovës, veçanërisht. A mendoni se kriza energjetike mund të përballohet edhe pas pavarësisë së vendit, si dhe a do të vazhdojë plani famëkeq ABC, që është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut dhe në këtë mënyrë është duke e varrosur edhe ekonominë, edhe ashtu të lodhur të Kosovës?

KRYETARI: Fjalën e ka ministrja e Energjetikës dhe e Minierave, zonja Justina Pula.

MINISTRJA JUSTINA PULA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më vjen keq që më parë shpejtova, por në fakt duhet të më kuptoni. S'jam deputete, prandaj edhe është hera e parë që dal këtu para jush.

Është e vërtetë që gjendja energjetike në Kosovë është shumë e rëndë dhe deputeti Zafir Berisha ka të drejtë që e ka parashtruar këtë pyetje. Ne jemi duke i marrë të gjitha masat dhe po përpiqemi që të ofrojmë një strategji se si do të dalim nga kjo krizë.

Unë i kam parashtruar dhe cekur disa elemente dhe ato do t'i lexoj, por, nëse dëshironi, në fund, mund edhe të bëjmë debate. Besoj se pas një periudhe shumë të shkurtër ne do të dalim konkretisht me të gjitha ato faza apo segmente se si do ta bëjmë zgjidhjen e problemeve të energjisë elektrike.

Gjendja e trashëguar teknike nuk mundëson furnizimin e rregullt me energji elektrike në situata kur kërkesa e konsumit është e lartë, e kjo ndodh sidomos gjatë dimrit. Rritja e pakontrolluar e konsumit e nxitur nga abuzimet afatgjate të energjisë elektrike, mungesa e kontrollit adekuat dhe të përgjegjshëm të konsumit, vlera marramendëse e borxhit të grumbulluar të konsumatorëve, sidomos në kategorinë e amvisërisë dhe mos pagesa e faturave, në vazhdimësi ka shkaktuar dhe po shkaktën probleme me furnizim me energji elektrike. Përpjekjet e deritashme për rritjen e inkasimit janë treguar të pasuksesshme, përkundër masave të kategorisë: A, B, C. Mospagesa e faturave ka nxitur abuzimin me energji elektrike, sidomos në ngrohje gjatë dimrit dhe si pasojë furnizimi në amvisni ka përmasa të patolerueshme.

Vetëm masat rigorozë, që duhet të ndërmerren për përmirësimin e kontrollit të konsumit, që Ministria i ka paraparë në Programin e vet të punës krahas një konsumi të plotë shoqëror për zbatimin e tyre, mund të shpijnë kah përmirësimi gradual dhe të qëndrueshëm i furnizimit me rrymë.

Çmimi i lartë i rrymës nga importi, krahas mospagesave, ka bërë që rryma e importuar të ngarkojë rënd buxhetin e Kosovës. Ndërtimi i kapaciteteve të reja që janë të parapara me planet afatgjate nga Programi i MEM-it, do t'i plotësojë nevojat e konsumit të rritjes, por kjo nuk duhet të kuptohet se energjia elektrike, nga këto kapacitete, nuk do të paguhet.

Unë do të jam këtu. Nëse keni ndonjë pyetje, do të përgjigjem.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë nga ana e deputetit?

Nuk ka!

Faleminderit!

Në radhë është pyetja e katërt. Deputeti Zafir Berisha parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Lus deputetin Zafir Berisha ta lexojë pyetjen.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Realisht, ne si shoqëri, në të gjitha sferat e jetës jemi duke kaluar në një situatë shumë të rëndë. Unë mendoj se, veçanërisht ministrat duhet të dalin me një strategji, pasi që ne jemi futur në periudhën e re politike dhe po vazhdon gjendja në të gjitha sferat me stilin e vjetër të menaxhimit. Në këtë rast unë kam shtruar një çështje që është shumë e ndjeshme dhe besoj se ministri për këtë do të ketë përgjigje adekuate.

Duke parë gjendjen e rëndë të pacientëve që kërkojnë shërbime nëpër spitalet rajonale dhe në QKUK, si dhe mungesën e barërave esenciale dhe të barërave të tjera dhe kujdesin e pamjaftueshëm ndaj pacientëve shtroj këtë pyetje: - Çfarë masash jeni duke ndërmarrë nëpër spitale, ku gjendja për pacientë është katastrofike, ndërsa pacientët detyrohen të blejnë çdo gjë që është elementare për ta?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetit, le t'i mundësohet vazhdimi i diskutimit. Ju lutem, ta shkurtoni pak pyetjen!

ZAFIR BERISHA: Supozohet se 70% e mjekëve kanë ordinanca private dhe i detyrojnë pacientët të paraqiten tek ata, sepse nëpër spitale, gjëja nuk ka kushte të mjaftueshme.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, zoti Alush Gashi.

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari zoti Kryetar,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Në veçanti falënderoj kolegun deputet për pyetjen e cila është esenciale për momentin dhe besoj se do të jetë edhe gjatë muajve në vijim.

Kësaj radhe, ne nuk kemi shumë argumente për t'u lavdëruar për sistemin shëndetësor në Kosovë, por pas vendimit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që ky të jetë një prioritet, mirëqenia e qytetarëve të Kosovës është një ndër pesë prioritetet për Konferencën e donatorëve dhe, sigurisht, prioriteti numër 1 për të gjithë ne. Unë besoj që së shpejti para këtij Kuvendi do të dalin me rezultate me të cilat Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi do të mburren.

Shkurt, menaxhimi i dobët dhe mosrespektimi i parasë publike dhe të donatorëve e kanë sjell shëndetësinë në gjendjen, që sipas argumenteve tona është e papranueshme.

Si prioritet i Qeverisë është se ne kemi arritur që këto ditë, ajo që ka qenë në vitin 2007 që vetëm 40% nga lista esenciale e barërave iu ka garantuar qytetarëve të Kosovës, ne kemi arritur t'u garantojmë se në vitin 2008 Qeveria e Kosovës do të sigurojë, së paku 80% nga lista e barërave esenciale edhe me këtë buxhet, i cili është, më pak se 40% . Kjo do të arrihet, do t'ju demonstrojmë me një menaxhim korrekt, të cilin mund t'ua argumentoj dhe në veçanti mund t'ua paraqes si dokumentacion në Kuvend.

Kemi arritur që më se 40% në mesatare, të sigurojmë sigurimin e barërave më lirë se një vit më parë. Kemi nënshkruar urdhrin administrativ, që qytetarët e vendit tonë, kualitetin e barërave ta kenë të Unionit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Kanadasë , të Zvicrës, të Izraelit dhe të Palestinës dhe e gjithë kjo, është e paraparë me ligj.

Sa i përket çështjes së punës private dhe asaj publike në sistemin shëndetësor të vendit tonë, zotërinj deputetë, Ligji i miratuar në Kuvendin e Kosovës, si një ligj i mirë – mundëson që ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, le t'i vazhdohet ministrit koha e diskutimit!

MINISTRI ALUSH GASHI: Unë, i nënshtrohem Rregullores. Zoti, Kryetar, a mund të vazhdoj? Ju faleminderit shumë!

Ligjet e vendit tonë mundësojnë që mjekët – punëtorë shëndetësorë të institucioneve private, gjysmë orari të punës, pas përfundimit të orarit të punës, ta kenë në institucionet private.

E dhëna juaj, zoti deputet, se 70% të tyre janë në institucionet private, nuk qëndron.

Më lejoni, t'ju informoj se Ministria e Shëndetësisë ka bërë një punë të shkëlqyeshme sa i përket licencimit, sipas ligjit. Ne i kemi të licencuar 3.055 mjekë, 680 stomatologë, 451 farmacistë, ndërsa të licencuar në praktika private janë vetëm 516, jo 70% të punëtorëve shëndetësorë që kanë aplikuar për licencim dhe janë refuzuar, deri në këtë moment janë 87 veta. Në Institucionet private – shëndetësore, në nivel të spitaleve, aplikues për licencim janë 12 veta dhe gjatë muajit mars ata do të marrin përgjigje. Ne nuk do të lejojmë që në vendin tonë të ketë institucione shëndetësore të palicencuara. Prandaj, shpresoj se duke iu falënderuar mbështetjes së Kryeministrit dhe Kuvendit, ne do të garantojmë se çmimi i furnizimit dhe transparenca do të jenë publike. Pra, nuk do të lejojmë që tenderët të mos jenë publik.

Ne kemi arritur që këto ditë të kemi një planifikim, në bazë të vendimit të Ministrisë së Ekonomisë së Financave, për shkurtim të procedurave të prokurimit që në këtë vit të mos teprojnë të holla. Ju garantoj se të hollat që janë për 12 muaj, ne do të demonstrojmë kapacitete menaxhuese që ato , nëse Thesari lejon, të harxhohen në gjashtëmujorin e parë

të këtij viti dhe me rishikim të buxhetit. Nëse ne demonstrojmë kapacitete të mira menaxhuese, Qeveria dhe Kuvendi do të na japin mjete shtesë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Berisha, a ka pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti Kryetar! Megjithatë, unë kam pritur përgjigje më praktike dhe jo artistike. Kështu, siç ishte, përgjigja iu dha me gjasë sekretarit permanent, jo mua. Unë, kërkoja të di sa është duke u marrë Ministria me përmirësimin e kushteve, sepse megjithatë, pacientët sillen korridoreve dhe maltreohen nga mjekët. Ju mund të jepni shifra, por unë mund të them se, në rast se ka deputetë në Parlamentin e Kosovës që janë mjekë, jam shumë i bindur se kanë ordianca private dhe këta mund të flasin për këtë më konkretisht. Dhe, jo siç supozoj për 70% , por mund të jenë edhe më shumë. Pak rëndësi ka se a janë të licencuar. Megjithatë, Zoti ministër, unë si deputet, i votuar nga qytetarët dhe edhe nga ata që janë nëpër korridore të spitalit, kisha kërkuar nga ju të merrni masa për ta

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, a keni përgjigjen? E ka fjalën ministri i Shëndetësisë, Alush Gashi.

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti deputet! Mendoj se për këtë çështje duhet të bëhet edhe më shumë.

Ne menduam se, nëse ua dorëzojmë të dhënat e shkruara, nuk ka nevojë të harxhojmë kohën, por vetëm më lejoni të them për këta dy muaj çfarë është ndërmarrë, nëse koha premtton.

Buxheti i alokuar gjatë janarit dhe shkurtit 2008, lidhur me këtë çështje, është 1.197.409 euro. Zotimet e mjeteve, për prioritetet të cilat janë: emergjenca, sallat e operacionit, listat esenciale, e tjera – janë 986.638 euro. Ne, ju garantojmë se Inspektorati Shëndetësor dhe Sanitar, do të jetë në veprim 24 orë. Kemi kërkuar mbështetje nga mediumet publike dhe private që puna e tyre të përcillet dhe, me mbështetjen e Kuvendit dhe të deputetëve si ju, unë besoj që kjo gjendje në muajt e parë të këtij viti do të ndryshojë.

Ne nuk e pranojmë këtë gjendje dhe e kemi një program shumë të qartë, i cili është një ndër pesë prioritetet e vendit tonë. Besoj se ne së shpejti do të kemi të dhëna plotësuese me të cilat do të kemi arsye edhe të mburremi.

KRYETARI: Faleminderit! Për këtë do të them unë diçka. Lus deputetët, që i bëjnë pyetjet dhe ministrat të cilët u përgjigjen, le ta lexojnë Rregulloren dhe pyetjet e përgjigjet t'i bëjnë konform saj.

Fjalën e ka anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Fole i pari, mirë bëre! Vetëm zbatoje Rregulloren se unë u paraqita për shkelje të Rregullores. Po shihet që në dy lëmenjtë që u bënë pyetjet, ka çka flitet, por ekziston forma e interpelancës. Mund të thirren në interpelancë ministrja e Energjetikës dhe ministri i Shëndetësisë.
Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, edhe nga ju!
Kalojmë në pyetjen e pestë, deputeti Driton Tali, nga AKR-ja ka pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Pasi që Kryeministrin nuk e kemi këtu, kërkoj nga deputeti, a dëshiron t'i përgjigjet ministrja e Energjetikës, Justina Pula.

DRITON TALI: Po, zoti Kryetar!
Të nderuar të pranishëm,

Në realitet, i kam dy pyetje, zoti Kryetar. Njëra mund t'i adresohet zonjës ministre të Energjetikës dhe të Minierave, kurse në tjetrën, ngase është e lehtë dhe nuk është Kryeministri këtu, mund të përgjigjen edhe zëvendëskryeministrat. Ashtu jemi marrë vesh, në pyetjet e lehta ata duhet të përgjigjen.

Pyetja e parë është, ndonëse, nuk e kemi ende programin e Qeverisë, por ...

KRYETARI: Ne e kemi vetëm një pyetje këtu, të cilën e keni adresuar.

DRITON TALI: Paska humbur në përkthim aty diku në një sirtar, por sidoqoftë, një pyetje po e bëj atëherë, edhe pse s'e kemi, po them edhe një herë, programin qeveritar...

KRYETARI: Deputet, lexoje pyetjen! Cili është qëndrimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me projektin e ndërtimit të Termocentralit "Kosova C"? Kjo është pyetja që...

DRITON TALI: Zoti Kryetar, desha t'ia lehtësoj zonjës ministre se ...

KRYETARI: Ju lutem, lexoje pyetjen!

DRITON TALI: Në rregull, atëherë. Pyetja është kjo: - Për shkak se janë dhënë disa deklarata nga Qeveria dhe ato deklarata pasqyrojnë njëfarë mjegullnajë në lidhje me Projektin "Kosova C."...

KRYETARI: Pyetja është marrë me shkrim. Ftoj ministren e Energjetikës dhe të Minierave, zonjën Justina Pula që të përgjigjet.

JUSTINA PULA: Të nderuar deputetë,
Është e vërtetë se Projekti "Kosova C" është një ndër projektet shumë ambicioze dhe ne si Ministri dhe Qeveri e parashohim si një projekt i cili do të ndikojë shumë në

zhvillimin ekonomik. Për momentin, nuk është stopuar, por ka stagnuar për t'i analizuar disa modalitete dhe opsione të cilat janë paraparë në projektin përfundimtar, i cili është bërë nga Agjencioni Evropian, faktikisht nga Banka Botërore. Mirëpo, unë këtu do ta lexoj qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me Projektin "Kosova C. Nëse ju nevojitet ne, sikur që thatë mund që në interpelancë të diskutojmë për secilin modalitet, për secilin opsion të cilën parashihet dhe pse ne në fakt e orientojmë.

Këtu do të japim vetëm disa informata dhe qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky projekt është në proces dhe fazë të ndjeshme, gjë që ka bërë që Qeveria të jetë e kujdesshme në masën më të lartë të respektimit të ligjit dhe përgjegjësisë shtetërore.

Nga të dhënat që u janë servuar institucioneve shtetërore të Kosovës, ky proces është përcjellë me lëshime reflektuese, mos transparencë të lartë dhe ndikime të ndryshme. Ky proces është ndërlikuar, është nën hetime të gjera.

Qeveria pret rezultat të organeve gjegjëse, pastaj do të marrë qëndrim përkatës.

Për vazhdim të Projektit, Qeveria është duke studiuar mundësitë që Kosova të ketë rrymë 24 orë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti, ka pyetje shtesë. Fjalën e ka zoti Driton Tali.

DRITON TALI: Sa e kam minutazhin, zoti kryetar, që të mos më mbetet fjala në gjysmë.

KRYETARI: Shikojeni Rregulloren e Punës!

DRITON TALI: Nejse, do të kem aq kohë sa t'ia rikujtoj Qeverisë qëndrimin e Qeverisë në hije, domethënë se Qeveria para se të ketë dalë në diell. Lexoni vetë fjalët tuaja çka keni thënë. E keni transkriptin e mbledhjes së mbajtur të Kuvendit, më 31 maj, në faqet 1, 4, 151 dhe 152, shumë qartë e ka dhënë zoti Bajrush Xhemajli qëndrimin e asaj Qeverie kundër 2100 megavatëve. Ju lutem, duhet ta keni këtë parasysh, nuk jeni më në opozitë.

KRYETARI: Urdhëro, ministre. Fjalën e ka ministrja Justina Pula. I keni 2 minuta kohë.

JUSTINA PUNA: I nderuari deputet, Driton Tali.

Unë kur e lexova këtë, në fakt nuk e ceka që "Kosova C" është 2100 megavatë. Më falni, thashë jemi duke i analizuar të gjitha modalitetet dhe opsionet rreth projektit shumë ambicioz "Kosova C". Nëse duam ta dimë "Kosova C" në fakt si projekt nuk e ka emrin, por e ka "Energjia e linjitit". Mund të jetë 5, 1500, 2000, prandaj, nuk kemi thënë, ju lutem mos e çoni dorën. Unë nuk po kuptoj, nëse të gjithë jemi deputetë në një Kuvend dhe ia dëshirojmë të mirën Kosovës, për zhvillim ekonomik, atëherë ne të gjithë duhet të kontribuojmë për një qasje. Unë nuk e kuptoj këtë. Nëse mendoni që e

bëni pyetjen për të na zënë – ja çka po bëni, unë mendoj se deputetët këtu e bëjnë pyetjen për një qasje shumë pozitive, për një zhvillim ekonomik, për një republikë të re.

KRYETAI: Ju faleminderit!

Lus deputetët që bëjnë pyetje, të mos ndërhyjnë në përgjigje. Dihet se ke të drejtë të bësh një pyetje, ke të drejtë për pyetje shtesë, por jo ndërhyrje në përgjigje. Përsëri po them, konsultoni Rregulloren e Punës.

Pyetja e gjashtë:

Deputetja Drita Kadriu, nga Partia Demokratike e Kosovës, ka pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajazitin.

Lus deputeten që ta lexojë pyetjen!

DRITA KADRIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Dy ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, do me thënë, me datën 19. shkurt 2008, kemi parë reagimet e një pjese të komunitetit serb, me ç'rast u dogjën dy pika doganore: në Jarinë të Leposaviqit dhe në Bërnjakë, të Zubin Potokut, si dhe u pengua funksionalizimi i Gjykatës në Mitrovicë.

Pyetja ime është: -Çfarë masash keni ndërmarrë për t'i evituar dëmet e shkaktuara në rastin e shkatërrimit të këtyre dy pikave doganore për të siguruar funksionalizimin e Gjykatës në Mitrovicë?

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit!

I nderuari, zoti Kryetar,

Kolegë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Zonja Kadriu,

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka përcjellë me vëmendje incidentet në vendkalimet kufitare. Këto incidente edhe pse të izoluara kanë qenë të organizuara. Tashmë është e qartë se tendenca ka qenë, përveç tjerash, për të provokuar edhe incidente serioze në vendkalimet kufitare.

Ne po punojmë në vazhdimësi që ta menaxhojmë me kujdes këtë situatë. Në këtë kontest edhe reagimi ynë ka qenë i kujdesshëm, i matur për të siguruar që të mos bëhen provokime më të thella.

Në anën tjetër, ne po vazhdojmë që të sigurojmë komunitetin serb se Kosova është edhe vendi i tyre dhe se ata duhet të ndërtojnë të ardhmen e tyre këtu. Pra, pavarësia e

Kosovës nuk është kërcenim, por mundësi për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kemi dërguar mesazhe politike, që dhuna është e papranueshme se Kosova është tashmë shtet i pavarur dhe sovran dhe i njohur ndërkombëtarisht dhe se jemi të përkushtuar për t'i mbrojtur institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Në bashkëpunim me UNMIK-un dhe KFOR-in, janë ndërmarrë masa të nevojshme për mbrojtjen e institucioneve shtetërore në veri të vendit, si: gjykatat, dogana, Shërbimi Korrektues, Hekurudhat e tjerë, si dhe infrastruktura strategjike në veri të vendit: urat, tunelet, telekomunikacionin dhe shërbimet e ujit, energjisë elektrike etj. Janë ndërmarrë, po ashtu, masa për përmirësimin e kontrollit kufitar dhe menaxhimin e kufijve. Tash jemi në proces të rivendosjes të Shërbimit Doganor në pikat kufitare, në pikat 1 dhe 31 dhe së shpejti do të rivendosen skanerët dhe kamerat të cilat kanë qenë atje. Po ashtu, është rivlerësuar edhe dëmi i shkaktuar. Shërbimi Doganor i Kosovës dhe Ministria jonë kanë obligimet e tyre dhe Qeveria, siç thashë, ka vlerësuar dëmin për t'u riparuar edhe gjendja, për t'u kthyer ajo siç ka qenë atje.

Kemi ndërmarrë, po ashtu, të gjitha masat për parandalimin e konsolidimit të krijimit të institucioneve paralele në pjesën Veriore të Kosovës.

Sa i përket funksionimit të Gjykatës në Mitrovicë e dini se ka pasur tendenca për ta penguar funksionimin e gjykatave, madje është tentuar të futet Gjykata nën ingerencat e Ministrisë të Drejtësisë së Serbisë. Kjo nuk është lejuar dhe presim normalizimin edhe pse mund ta kuptoni, se edhe sot derisa po flasim këtu, ka tendenca, aktivitete të tilla të paligjshme, jo legale të disa pjesëtarëve të manipuluar të komunitetit serb atje.

Edhe një çështje tjetër, meqë është e lidhur me këtë...

KRYETARI: Zoti ministër, e keni kaluar kohën.
A ka pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Ju faleminderit për përgjigjen!

KRYETARI: A ka pyetje shtesë? Nuk ka! Pyetja vijuese, e shtata me radhë. Deputetja Gjylnaze Sylja nga AAK-ja ka pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. A dëshironi ta lexoni pyetjen?
Lus regjinë që t'ia japë fjalën deputetes Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryetar, është ministri i Ekonomisë dhe i Financave dhe nëse është i përgatitur, unë kisha dashur ta dëgjoj përgjigjen, por nëse jo, po e lexoj pyetjen.
A është ministri i përgatitur?

KRYETARI: Lexoje pyetjen, pastaj vendos!

GJYLNAZE SYLA: Pa shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nuk ka çështje më me rëndësi për shtetasit e Republikës së Kosovës se sa zhvillimi ekonomik, i cili është i

domosdoshëm për zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kualitetit të jetës. Një mundësi e mirë për këtë është anëtarësimi në institucionet ndërkombëtare financiare, siç janë: Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në këtë periudhë, është me rëndësi që të fillojë menjëherë aplikimi në këto dy institucione të rëndësishme. Prandaj, pyes Qeverinë se a ka ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me anëtarësimin në këto dy institucione?

Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: A doni të përgjigjeni? Zoti Shala e ka fjalën.

AHMET SHALA: Ju faleminderit!

Zonja Gjylnaze, si duket, kjo është ndoshta pyetje më e lehtë se sa për Kryeministrin, andaj besoj se do t'i përgjigjem me lehtësi.

Një nga synimet dhe objektivat tona është që brenda këtij viti në disa nga institucionet e rëndësishme financiare ndërkombëtare do të bëhemi anëtarë dhe jemi duke u përgatitur për këtë. Procedurat janë goxha sfiduese, por jemi në negociata të drejtpërdrejta me të tri institucionet kryesore financiare ndërkombëtare me të cilat së shpejti, në mënyrë shumë të koordinuar dhe mendoj strategjia është që po aq me koordinim të mirëfilltë, siç është bërë edhe pavarësimi, do të bëhet edhe anëtarësimi i Kosovës në këto institucione ndërkombëtare. Unë personalisht jam në kontakt me të gjitha për këto. Javën që vjen, të hënën e kam një delegacion të njërit nga institucionet ndërkombëtare financiare dhe besoj që shumë shpejt, para përfundimit të vitit, do të jenë rezultatet e para. Kjo është përgjigja që mund ta jap sot. Natyrisht, ne duhet të jemi të matur, të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm, me të gjitha procedurat të mos provokojmë dhe procedurat e miqve, ashtu siç e kemi bërë koordinimin për shpalljen e pavarësisë, ashtu do ta bëjmë. E dini, procedurat shkojnë me votime. Duhet që në disa nga institucionet të kenë më shumë se 51% të votave, në disa edhe më shumë, prandaj me progresin që e kemi në njohjen e pavarësisë nga shtetet e rëndësishme që kanë vota të rëndësishme në atë forum ku mbahen vendimet, neve do ecim me këtë, por jemi shumë të përgjegjshëm dhe binduni që sigurisht do ta bëjmë atë dhe unë jam i sigurt që kah vjeshta do t'i keni raportet e sakta për këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ka pyetje shtesë?

Urdhëroni!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

Ju zoti Ministër folët për veprime joformale, unë po flasë për veprime konkrete, qeveritare. A keni bërë ligj për anëtarësim dhe mbasi është Kryeministri këtu dhe pyetja ime iu është drejtuar atij, lus Kryeministrin t'i përgjigjet pyetjes sime shtesë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zonja deputete, unë për këto punë jam këtu për t'u përgjigjur dhe për të dhënë llogari, natyrisht para qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës.

Tash, pas pavarësimit të Kosovës, fillimit të funksionimit shtetëror realisht prej institucioneve të Kosovës, kemi filluar edhe formalisht aplikimin për Fondin Momental Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kryeministër!

Po kuptoj. Vazhdojmë me pyetjen e tretë të bërë nga deputetja Qamile Morina, LDD, për ministrin e Shëndetësisë.

Le ta lexojë pyetjen!

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Zoti ministër, ju trashëguat një gjendje të rëndë në sistemin shëndetësor. Gjendja e rëndë e krijuar në shëndetësi është si pasojë e njërit nga shkaqet kryesore që është financimi i paqëndrueshëm.

Sistemi ynë shëndetësor po përballët me zvogëlimin e vazhdueshëm të fondeve shëndetësore nga Buxheti i Kosovës. Kështu, për vitin 2002 janë ndarë 20% nga buxheti për Shëndetësi, kurse në vitin 2005 vetëm 12%, për vitin 2008 janë paraparë 5% të Buxhetit të Kosovës. Kësaj paqëndrueshmërie financiare po i kontribuon edhe mungesa e infrastrukturës ligjore për sigurimet shëndetësore. Kështu Kosova, mbase po mbetet shteti i vetëm në Evropë pa sigurime shëndetësore.

Pyetja ime është: - Cili është koncepti i Qeverisë së Kosovës për skemën e sigurimit shëndetësor, kur kjo çështje deri më tani nuk është rregulluar me ligj dhe kur dihet se në strategjinë legislative të Qeverisë për vitin...

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Ministri i Shëndetësisë, zoti Alush Gashi.

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Përshëndes zotin Kryeministër,

Faleminderit zonja deputete, e nderuara profesoreshë e Mjekësisë,

Ministria e Shëndetësisë e ka hartuar Ligjin e sigurimeve shëndetësore në vitin 2004, dhe e ka dërguar në Qeveri në vitin 2005. Ligji për sigurime shëndetësore është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës me 22 shkurt të vitit 2007. Pas aprovimit është dërguar në zyrën e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Më 26 qershor 2007, përmes shkresës 05-2312 jemi informuar se Zyra e Përfaqësuesit Special e ka kthyer ligjin në Qeveri për rishqyrtim dhe vlerësim të përgjithshëm të ndikimit financiar dhe ekonomik.

Në strategjinë legislative të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2008, nuk është paraparë hartimi i ligjit të ri, meqenëse Ligji për sigurime shëndetësore duhet të rishqyrtohet sipas propozimit të Zyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Ministria e Shëndetësisë ka kërkuar bashkëpunim me Bankën Botërore për të studiuar fizibilitetin dhe ndikimin ekonomik dhe financiar të këtij ligji. Presim që në ditët e ardhshme të kemi rezultate të studimit të Bankës Botërore për të vendosur për hapat e mëtejme.

Ministria e Shëndetësisë, do t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për shqyrtim sa më të plotë të të gjithë faktorëve relevantë për plotësimin e këtij ligji në harmoni me mundësitë ekonomike të vendin dhe interesin e popullatës.

Pajtohem me ju, zonja deputete se mundësitë buxhetore janë ato që janë dhe diku përfshinë afër 30% të nevojave optimale, por ne duhet të jemi të sinqertë para vetvetes dhe qytetarëve të Kosovës, se një prej arsyeve të zvogëlimit prej 20% deri në 5% është menaxhimi i keq dhe mungesa e demonstrimit të kapaciteteve menaxhuese. Unë ju garantoj se këtë vit ne do ta ndryshojmë gjendjen. Ne do të demonstrojmë që kemi kapacitete për menaxhim edhe nën 2, në mirëkuptim të Kryeministrit dhe tërë Kabinetit Qeveritar, ne jemi duke përgatitur një program që do të dalë para Qeverisë dhe Kuvendi për burime shtesë të financimit të shëndetësisë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ministër!

Keni pyetje shtesë, zonja deputete? Jo!

I njoftoj deputetët që, nëse pyetja nuk merr përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në Buletinin e Kuvendit. Ky është i vetmi ndëshkim që mund ta bëjë Kuvendi.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- Raporti për aktivitetin e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2007

Në pajtim me nenin 82 të Ligjit për prokurimin publik, Komisioni Rregullator për Prokurim Publik, Kuvendit ia ka paraqitur raportin vjetor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullator për Prokurim Publik lidhur me aktivitetet e prokurimit publik për vitin 2007, duke i rekomanduar Kryesisë që atë ta radhisë për shqyrtim në seancë plenare. Materialet u janë shpërndarë deputetëve.

Tani, sipas radhës fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci për t'i dhënë vlerësimet lidhur me Raportin. Zoti Koci, e keni fjalën.

GANI KOCI: I nderuari zoti kryesues i Kuvendit,

I nderuari Kryeministër bashkë me zëvendësministra dhe Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Ne si Komision e kemi shqyrtuar raportin e Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik, por duhet të ndalem paraprakisht në një çështje, që sipas Ligjit për prokurimin publik, neni 82, pika 2, raportin e këtij organi, para Kuvendit e paraqet kryesuesi i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik dhe ne si Komision, pastaj japim mendimet dhe qëndrimet tona lidhur me këtë raport, duke i dhënë edhe mundësitë, pastaj të shprehen edhe grupet parlamentare edhe deputetët. Ne mund t'i japim vetëm ato konstatimet tona rreth këtij raporti, por nuk di kush do t'u përgjigjet: kërkesave, vërejtjeve, pyetjeve dhe qëndrimeve tona që i kemi si deputetë. Prandaj, paraprakisht, është dashur të thirret kryesuesi i Komisionit që ta paraqesë raportin këtu. Këtë, sigurisht, Kryesia duhet ta dijë dhe pastaj Komisioni dhe grupet parlamentare të përgjigjen rreth raportit. Nëse ne flasim vetëm për vërejtjet këtu, pa e dëgjuar fjalën e kryesuesit, atëherë nuk di se si..., kur e dimë se ky është organ që është themeluar nga ky Kuvend dhe i përgjigjet këtij Kuvendi.

KRYESUESI: Zoti Koci, ju faleminderit, por ju jeni të informuar dhe secili deputet e di që raporti është shpërndarë. Secili e kenë pasur në shtëpitë tuaja, në kasafortat tuaja. Ne, nuk mund t'i trajtojmë njësoj si ministrat, si bordet që të na flasin para e prapa debateve. Ne po procedojmë sipas rregullave që janë vendosur në Kryesi.

Kush ka vërejtje lidhur me raportin, le të urdhërojë? Më së pari, në emër të grupeve parlamentare. Kush do të flasë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës?

Zoti Kuçi, ka vërejtje procedurale.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Zoti Koci ka të drejtë shumë dhe Kryesia e Kuvendit nuk mund të vë rregulla në kundërshtim me Rregulloren. Kryesuesi i Komisionit është i zgjedhur nga Kuvendi dhe i përgjigjet Kuvendit. Ai duhet të vijë të raportojë këtu dhe ne më pastaj ne diskutojmë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryesuesi i Komisionit është këtu në sallë dhe është duke pritur që të japë përgjigjet në raportin që e ka bërë sipas Rregullores. Unë e kam, sipas vendimit që është marrë në Kryesi dhe sipas porosisë së kryetarit, që kjo procedurë të vazhdojë kështu. Pra, rregullat i njohim edhe ne zoti Kuçi, megjithatë mënyra e zgjedhjes e kompetencave dhe e përgjegjësisë duhet të jetë e rregulluar me ligj në të ardhmen dhe jo të ngarkojmë borde dhe që të mos ketë askush mundësi t'i shkarkojë pastaj.

Ju, si të doni, unë jam që, në qoftë se ju mendoni se duhet të lexohet raporti nga kryetari i KRPP-së, unë nuk kam asgjë kundër, nuk prishë punë.

Kërkoj që të deklarohen kryetarët e grupeve parlamentare, a janë që shefi i KRPP-së të raportojë njëherë dhe pastaj të hapet debati. Zoti Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së. Çështja është të deklarohet se a do të fillojmë me leximin e raportit, apo sipas...?

RAMË BUJA: Zoti kryesues, atëherë, nëse jemi në këtë pozicion, unë në emër të Grupit Parlamentar them që ftesa nuk mund t'i bëhet tani për të ardhur, tani për të raportuar dhe kjo çështje do të shtyhet për faktin që duhet bërë ftesë zyrtare zotëriut për të ardhur për të raportuar zyrtarisht në Kuvendin e Kosovës. Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar, unë jam për ta shtyrë këtë pikë.

KRYESUESI: Mendoj se është një keqkuptim në këtë rast. Zoti Duli është këtu me sa po e shoh, duke pritur që ta marrë fjalën. Problemi është si është vendosur në Kryesi. Unë kërkoj që zoti Sabri Hamiti të sqarojë si është proceduar në Kryesi dhe si është dhënë mendimi në Kryesi?

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që nuk është koha të bëjmë debate për rregulla dhe rregullore. Nuk është hera e parë që ne shqyrtojmë raporte të institucioneve të tilla. Kryetari është këtu, mirëpo këtu mund të paraqiten vërejtjet e grupeve parlamentare dhe kur të ketë komentime në fund, ai është i gatshëm që të përgjigjet, nëse i drejtohen nevojat dhe kërkesat për përgjigje. Unë mendoj që nuk është koha tash të votojmë a të hiqet pika e rendit të ditës, të cilën nuk e kontestoi asnjë grup parlamentar në fillim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kuçi dëshiron që ta marrë fjalën për procedurën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë dua të replikoj me prof. Sabri Hamitin. Besoj se një gjë duhet ta kemi të qartë. Ky Komision është i zgjedhur nga Kuvendi.

KRYESUESI: Zoti Kuçi, nuk ta ka përmendur emrin zoti Hamiti dhe nuk keni të drejtë të replikoni.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë besoj që kam të drejtë për replikë...

KRYESUESI: Jo, nuk ki të drejtë të bësh replikë përderisa nuk ta ka përmendur emrin. Më falni, shokë jemi, por...

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Unë kam qenë njëri nga ata që kanë shkruar Rregulloren e Kuvendit, kur të përmenden edhe temat që i keni diskutuar, keni të drejtë për të bërë replikë. Nuk mundet një komision të raportojë në Kuvend, të zgjidhet nga Kuvendi pa qenë të pranishëm anëtarët e Komisionit.

Raporti i këtij Komisioni shqyrtohet në Kuvend. Nëse nuk e miratojnë raportin, shkarkohen njerëzit. Nuk mund të flasim ndërmjet veti ne për Komisionin, e ata nuk janë askund. Kjo është punë shumë serioze, jo vetëm për këtë komision, por për të gjitha. Me kë do ta flasim ne tash, me njëri-tjetrin, nuk ka asnjë arsye. Ata janë zgjedhur në Kuvend, janë të votuar në Kuvend, i raportojnë Kuvendit. Urdhëroni, vijnë ata raportojnë, diskutojmë, e miratojmë Raportin, ju bëjmë vërejtje, kritika ose jo edhe ata në fund, sikurse një Qeveri që i raporton për punën e vet Kuvendit, edhe ky komision raporton dhe mos të vëmë makijazh në Kuvend.

KRYESUESI: Po, zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Tash, zëvendëskryeministri ma përmendi emrin e po më shtinë të flas, edhe pse s' patëm nevojë.

Unë po ju them dhe kryesuesi e di që kryetari i Komisionit është në sallë. Është i gatshëm të përgjigjet, por nëse nuk thirret të përgjigjet, edhe me të gjitha rregullat, dhe rregullat edhe të kësaj seance, ai nuk mund ta marrë fjalën. Unë thashë, meqë janë të gatshëm të përgjigjen, organet e Kuvendit diskutojnë, e pranojnë, s'e pranojnë, bëjnë pyetje, jep përgjigje nëse ne e thërrasim. Mënyrë tjetër që njeriu ta marrë fjalën në këtë foltore të Kuvendit nuk ka pa qenë deputet. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kuçi, unë dua vetëm ta lexoj Rregullën 46 lidhur me raportet. Si rregull, raportet e Komisionit për Kuvendin bëhen me shkrim. Raportet e komisionit përgjegjës raportues mund të plotësohen me gojë nga kryetari i komisionit përgjegjës raportues, nga një anëtar i caktuar ose raportuesi i tij. Kjo është rregulla. Urdhëroni, për replikë, Hajredin Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Tash replikën e parë e kam me ju, zoti Haliti. I keni ngatërruar komisionet. Ju po flisni për komisionet e Kuvendit. Këtu është fjala për një komision të pavarur të Kuvendit dhe nuk ka asnjë logjikë që të fillojë debati për atë komision nëse nuk raportohet nga kryetari i komisionit.

Pika e parë do të jetë Raporti i tij. Mbi bazën e raportimit të tij, ne diskutojmë. Ne s'mund të diskutojmë dhe ta thërrasim pasdite e t'i themi: "më duket se kemi folur diçka për ty". Ai duhet të jetë këtu. Kryesia e Kuvendit ka bërë gabim që s'e ka thirrur, në radhë të parë raportuesin, kryetarin e Komisionit, e pastaj diskutojmë ne.

KRYESUESI: Pasi që nuk e ka fjalën askush dhe kemi një keqkuptim lidhur me procedurat, kërkoj një pauzë prej 15 minutash, një takim të përbashkët të kryetarëve të grupeve parlamentare me Kryesinë.

Takimi mbahet në pjesën e Kabinetit të Kryetarit.

Vazhdimi i punës pas pauzës

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë seancën. Në mbledhjen konsultative të Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare vendosëm që të vazhdojmë sipas marrëveshjes, ashtu siç e filluam seancën që të fillojmë debatin lidhur me raportin e Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik.

Sipas renditjes, të drejtën për të dhënë vërejtje në raportin në fjalë ka Komisioni për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, i cili atë e ka miratuar në parim dhe e ka dërguar në Kuvend, për shqyrtim. Rekomandimi është që të shqyrtohet në Kuvend.

Interpretimi i Rregullores është shumë kuptimor, do të thosha nga ata që diskutuan. Megjithatë, ne nuk kemi asnjë mocion për KRPP-në, ndaj të cilit KRPP-ja do të kishte obligim, prandaj, sipas rregullave, të gjithë deputetët mund të diskutojnë lidhur me raportin sipas renditjes.

Unë dua ta bëj një përjashtim në raport me kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili u paraqit më parë dhe kërkoi fjalën për procedurë. Tani, fjalën sipas radhës ia jap prapë zotit Gani Koci, që t'i paraqesë vërejtjet e tij lidhur me raportin, jo për procedurat.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Veprimi ynë bazohet në procedurat që i kemi miratuar dhe duhet të sillemi në bazë të tyre. Çdo vit kalendarik Komisioni Rregullator ia paraqet një raport Qeverisë dhe Kuvendit. Pikërisht nga ky nen, 86.2 ishte kërkesa që ai t'ia paraqesë raportin Kuvendit këtu. Fatmirësisht, këtë raport e ka paraqitur në Komision dhe paraprakisht Komisioni e ka shqyrtuar në prezencën e përfaqësuesve të Komisionit dhe ka nxjerrë përfundime, që me shkrim i ka dorëzuar Kuvendit, dhe kërkesën që të shqyrtohet edhe në Kuvend.

Bazuar në Kreun V, pikat a) dhe b) të Kornizës për Vetëqeverisje Lokale dhe në rregullat 51.2 dhe 3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, nenin 82 që e citova më herët, pika 2 pika i, nën I të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 2007/20, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 6 mars ka shqyrtuar raportin e Komisionit Rregullator për Prokurim Publik për aktivitetet e prokurimit publik për vitin 2007.

(Ndërprerje nga regjia)

GANI KOCI: Unë mund ta ndërpres këtë, mirëpo po e pres fjalën e kryesuesit rreth kësaj çështjeje.

KRYESUESI: Regjia, deputeti Koci mund ta vazhdojë diskutimin. Po vazhdojmë. Sipas procedurës, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ose përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike lidhur me raportin.

Zoti Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Është një propozim i mëhershëm i zotit Kuçi që të hidhet në votim në Parlament, a të lexohet raporti nga përfaqësuesi i KRPP-së?

Ne u mbledhëm si Kryesi së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare dhe vendosëm që ta ndjekim praktikën e së kaluarës. Kjo praktikë është zbatuar edhe në raport me Komisionin e Energjetikës, kur ka pasur të raportojë. Vetëm ART-ja ka raportuar me kërkesë të veçantë. Unë s’kam asnjë kundërshtim që të hidhet në votim edhe propozimi i zotit Kuçi qysh s’kam, s’mund të kem as kundërshtim personalisht. Mund të votoj, por jo ta kundërshtoj në pozitën që jam tani.

Megjithatë, propozimi është bërë. E ke bërë zoti Kuçi. Kërkoj nga kryetarët e grupeve parlamentare që të deklarojnë a po e hedhim në votim propozimin e zotit Kuçi dhe a të votojmë për propozimin në fjalë?

Zoti Kuçi dëshiron të jep sqarim plotësues. Urdhëro, zoti Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Shikoni, nuk është kjo çështje subjektive dhe tani duket që kalon në subjektivitet, gjë që s’është mirë. Edhe Kryesia e Kuvendit, edhe shefat e grupeve parlamentare, propozimi është shumë konkret. Ne kemi kërkuar që të procedohet, nëse ka qenë praktikë, unë po ju them praktikat e mira duhet të vazhdojmë, të këqijat duhet t’i ndalojmë.

E dyta, praktika nuk guxon të jetë në kundërshtim me rregullat. Nëse dëshirojmë, po e ndryshojmë Rregulloren.

E treta, në nenin 82, ai i raporton edhe Qeverisë, edhe Kuvendit. Qeveria nuk ka qëndrim për të. Ende s’e ka shqyrtuar, nuk i ka ardhur me kohë. E mira e së mirës është, pa e nxitur çështjen, ta shtyjme për mbledhjen e radhës së Kuvendit. Lë të përgatitemi edhe ne, marrim vendim, përndryshe, diskutimi i sotëm edhe atë që e përmendët lidhur me Rregullatorin e Energjetikës ka qenë gabim, po ju them. Besoj se anëtarët e Komisionit nuk janë ndie mirë kur është folur për raportin e tyre dhe nuk kanë qenë prezentë. Edhe sot ne mund ta bëjmë raportin sa për sy e faqe, por ky Kuvend, secili komision i pavarur, ky është Komision i pavarur që i vjen këtij Kuvendi, duhet të raportojë. Diskutimet mund të jenë të secili deputet, të secilit grup parlamentar.

Tash po e them, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe në emër të Qeverisë, kërkoj të shtyhet

KRYESUESI: Prapë po ju them se propozimin shtesë për ta shtyrë raportin, sipas Rregullores, jam i obliguar ta hedh në diskutim. Kërkoj që kryetarët e grupeve parlamentare të deklarojnë a janë për ta shtyrë raportin për një seancë tjetër të Parlamentit, apo jo?

Fjalën e ka përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryesues!

Unë besoj që në këtë situatë ne nuk mund t'i peshojmë sa të drejtë ka njëra ose tjetra tezë. Por, më së miri do të ishte, sipas propozimit tonë, që të votojnë deputetët e Parlamentit për këtë çështje, jo shefat e grupeve, sepse ne s'mund ta marrim të drejtën që të flasim në emër të të gjithëve.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i AKR-së, Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryesues!

Unë, në emër të Grupit po flas, por jam edhe anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne e kemi shqyrtuar këtë raport në prani të anëtarëve të Komisionit Rregullator për Prokurimin Publik. Çështja ka qenë se raporti është i përpiluar në formë analitike më shumë dhe në formë skematike, në këtë rast. Mirëpo, aty është edhe ndryshueshmëria për kohën sa ka zgjatur përpilimi i raportit, ka një kolizion, janë dy ligje të thirrura me këtë çështje. Për procedurat, se a janë shkelur a jo, a kemi marrë ndonjë rekomandim nga Qeveria e Kosovës, besoj se gabimi i madh është se është pranuar në Kuvend ky raport. Në këtë rast ne mendojmë se duhet ta votojmë sot, duhet të votohet për raportin, pavarësisht se Komisioni e ka a miratuar në parim. Ne do të shkojmë në bazë të procedurave të Kuvendit, jo të procedurave që në këtë rast mendohet se janë shkelur në Qeverinë e Kosovës. Qeveria është dashur të jetë e njoftuar më konkretisht lidhur me këtë çështje. Neve nuk na përket sa mund të bëjmë sot lidhur me rastin konkret, se a mund të votojmë apo jo, por për kërkesën që është bërë për t'u futur në rendin e ditës, besoj se ne sot duhet të votojmë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryesues!

Edhe ne në Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendojmë se duhet të votohet sot, sepse është shkelje e Rregullores edhe e praktikës parlamentare të ndryshojë agjenda e Kuvendit brendapërbrenda Kuvendit, pa një kërkesë paraprake, që një javë është diskutuar kjo pikë e rendit të ditës. Nuk besoj se ka pasur grup parlamentar që nuk e ka ditur që kjo pikë e rendit të ditës do të jetë sot. Ka pasur mundësi të kërkohet më herët të shtyhet. Në fund të fundit, kur një herë kam thënë se Qeveria e cakton agjendën e Kuvendit në këtë mënyrë, Kryetari më ka thënë se nuk është e vërtetë. Sot po shihet se Qeveria po e dikton agjendën e Kuvendit.

Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryesues!

E para, do të ishte shumë më mirë që partnerët e koalicionit të merren vesh mes veti, sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me rregullimin dhe funksionimin e institucioneve të këtyre mekanizmave.

E dyta, ne si Grup Parlamentar e kemi filluar këtë seancë plenare me një rend dite dhe ai duhet të respektohet në përpikëri dhe çdo ndryshim i tij ka procedura. Deri më tash nuk kemi dëgjuar për ndonjë propozim të ri, përpos atij që Grupi Parlamentar i PDK-së e dha.

Ne si Grup Parlamentar jemi të përgatitur që të procedojmë me rendin e ditës.
Faleminderit!

KRYESUESI: Për procedurë është paraqitur zoti Buja.

RAMË BUJA: Të nderuar kolegë,
Unë para se të shkoj në atë konsultën 15 minuta, ku më duket s'bëmë gjë, ju thashë se ka një procedurë kërkesa për të ardhur dhe për të raportuar Komisioni i caktuar. Jam dakord që zotërinjtë janë prapa atje, por s'i ka ftuar kush me ftesë zyrtare për të ardhur për të raportuar. Është një kërkesë këtu për t'u hedhur në votim kërkesë e një deputeti dhe zëvendëskryeministri. Andaj, duhet të vihet në votim ajo dhe pastaj të shohim se si procedojmë. Ju lutem, nuk kemi pse ta zgjasim këtë në pakufi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja!
Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupi Parlamentar "7+", zoti Merxha.

HAXHI MERXHA: Zoti Kryesues, ne pajtohemi që të shtyhet, sepse s'jemi marrë mirë vesh.

KRYESUESI: Zoti Kuçi ka një sqarim shtesë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Kësaj radhe, ndoshta më duhet të jem pak më i hapur se çka kam menduar të them unë, e çka kemi menduar ne si Qeveri.

Çështja e tenderëve në Kosovës është problemi më i madh i korrupsionit. Nëse dikujt i konvenon që brenda dite të raportojë dhe brenda ditës të kalojë një raport për të cilën flitet që miliona janë korruptuar, le të vazhdojë. Por, Qeveria ju premtoj që do të vazhdojë t'i shikojë krejt tenderët, krejt mënyrat e procedimit. Dhe, urdhëroni me vota kaloni, por me ligj nuk kalon, po ju premtoj këtu.

E dyta, Qeveria kërkon tash, deri në orën 15,00 pauzë. Mund të kalojë edhe me vota, mund të bëjnë gjëra të tjera. Çështja e tenderëve do të jetë çështje e ligjit, çështje e policisë, çështje e gjykatave.

Ky Kuvend nuk është mirë t'i kryej raportet sa për sy e faqe. Të gjithë neve, në rrugë, në gazeta, kudo na thoni, nëse thoni që janë të korruptuar, se tenderët merren me 5%, 10%, 20%, urdhëroni të flasim në Kuvend. E dini të gjithë që ka tenderë të përfolur, që ka raporte të shkelura, çështje të cilat nuk janë diskutuar sa duhet në Kuvend. Sa flasim në gazeta, sa i japim informata të fshehta ndonjë gazete, ndonjë televizioni ose dikujt tjetër, urdhëroni diskutojmë në Kuvend, do t'i hapim të gjitha letrat. Kjo është pjesë e luftës së Qeverisë kundër korrupsionit. Ne dëshirojmë transparencë, nuk duam t'i

prejudikojmë gjërat, por ta dimë saktësisht nëse ka dilema për 20 tenderë, për një tender, le të na raportojnë zotërinjtë si ka shkuar procedura. Po u them se Qeveria e Kosovës ka informata të sakta se ka pasur shkelje të procedurave gjatë dhënies së tenderëve dhe ka pasur “ligjshmëri” nga ky komision për ata tenderë. Kur të vijë koha për të debatuar, ne do të dalim edhe me diskutime konkrete.

KRYESUESI: Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të SLS-së nuk është. Atëherë, kemi një propozim për ta shtyrë debatin për seancën e ardhshme. Lus deputetët që të votojnë. Sipas Rregullores, nuk bëhet debat për këtë punë. Prandaj, lus deputetët që të përgatiten për votim lidhur me propozimin që është dhënë që ta shtyjme për seancën e ardhshme, le të merremi vesh më mirë, ose të mos merrem vesh, nuk e di si ndodh, ose si të votohet, ashtu do të veprohet. Mendoj që rruga e vetme e mundshme demokratike është kjo që ta hedhim në votim.

Ju lus, të nderuar deputetë, që të përgatiteni për votim! Teknika, përgatituni për votim! Votohet për ta shtyrë ose jo debatin për seancën e ardhshme, jo pa kufi. Do të thotë, për seancën e ardhshme me qenë se u dhënë arsyetimet në emër të Qeverisë. Faleminderit!

Teknika, gati për votim, a ta shtyjme seancën a mos ta shtyjme.

Dua t’ua lexoj Rregullën 30, pikën 2 të Rregullores, që t’ua përkujtoj.

“Për mocion, për ta shtyrë debatin për një datë të caktuar, në një debat të ardhshëm, dhe për mocionin për ta shtyrë seancën menjëherë, mbahet votim pa debat”. Kjo është Rregullorja, unë nuk mund të dal prej saj, nuk mund të jap diçka tjetër. Prandaj, po dua t’ju lus edhe një herë që të votojmë.

Teknika, edhe një herë gati për votim, ju lutem, teknika!

Votojmë tani:

Tani ata që janë për ta shtyrë, le të votojnë tani me ngritje dore, sa janë?

Ata që janë kundër për ta shtyrë, që nuk kanë kartela? S’ka asnjë!

Me 48 vota me votim elektronik, 4 vota me dorë, që bëjnë 52 vota për ta shtyrë mbledhjen, ose pikën e rendit të ditës për seancën e ardhshme, dhe janë 28 vota “kundër” dhe 7 abstenime.

Prandaj, sipas Rregullores, konstatoj që pika e rendit të ditës në fjalë shtyhet për seancën e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

Është kërkuar nga Qeveria, për shkak të angazhimeve që i ka, pauzë deri në ora 15,00.

Ne mund ta vazhdojmë punën, nuk kemi ndonjë problem, por çështjet të cilat kemi për t’i debatuar lidhen shumë me Qeverinë, me angazhimet e Qeverisë dhe disa propozime të veçanta që janë, mendoj se Qeveria domosdo duhet të jetë këtu e pranishme. Faleminderit!

Në orën 15,00, vazhdojmë seancën.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë seancën e pasdites. Ju njoftoj se në sallë janë 89 deputetë, andaj mund të vazhdojmë punën. Për shkak të mungesës së ministrit Arsim Bajrami, kërkoj nga ju që ta kemi në rend dite pikën e fundit të rendit të ditës, pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shërbime Publike Administratë Lokale dhe Media për shqyrtimin e rekomandimit për emërimin e 2 anëtarëve të Këshillit në Komisionin e Pavarur të Mediave**

Ndërkohë, besoj që vjen ministri, sepse duhet të bëhet një tërheqje e një kandidati se kanë shumë, do të respektohet ligji. Jeni darod? Kush është “për”? Faleminderit!

Ju lutem, kur fillon seanca, i ndërpritni bisedimet mes veti!

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit ad-hoc parlamentar nga Legjislatura e dytë për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe të njëjtin ia ka propozuar Kuvendit për miratim. Materiali u është shpërndarë deputetëve.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,
Kabinet qeveritar dhe kolegë,

Realisht, unë desha që fjalën para kryetarit të Komisionit të tanishëm ta marrë kryetari i Komisionit ad-hoc i këtij rasti që është krijuar në legjislaturën e kaluar. Megjithatë, unë do të jap shpjegime tani.

Komisioni ad-hoc parlamentar për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2007 ka përzgjedhur 2 nga 4 të propozuarit për emërim të anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe ka nxjerrë rekomandim që Kuvendit të Kosovës t’i propozojë emërimin e 2 anëtarëve të përzgjedhur.

Tani kalojmë te Komisioni. Me datën 5 shkurt 2008, Komisioni i Pavarur për Media i është drejtuar Kuvendit të Kosovës që të bëjë emërimin e 2 anëtarëve të Këshillit. Sipas Komisionit të Pavarur për Media, kjo është çështje urgjente, sepse mungesa e kuorumit të anëtarëve të Këshillit ndikon në mosfunksionimin e punës së KPM-së. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur më 19. 2. 2008, ka shqyrtuar kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media dhe i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesën që kjo çështje të procedohet më tutje me

qëllim që Këshilli t'i përmbushë objektivat dhe prioritetet e veta të përcaktuara për vitin 2008.

Andaj, unë në emër të këtij Komisioni dhe në emër të Grupit Parlamentar, ju ftoj që të votoni 2 anëtarët e rinj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Sipas radhës, fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, zoti Fehmi Mujota.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

I nderuari Kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Në këtë rast flas në cilësinë edhe të anëtarit të Komisionit ad-hoc, përkatësisht në cilësinë e nënkryetarit të këtij Komisionit, i cili punën e vet e ka mbaruar në nëntor të vitit të kaluar, afërsisht në përmbyllje të legjislaturës së kaluar.

Sipas Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, ky Komision ad-hoc është mbledhur më 9 nëntor 2007, ka pas numrin e nevojshëm për të punuar dhe ka bërë përzgjedhjen, sipas mandatit që ka si Komision ad-hoc, prej 4 vetave të propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media për të rekomanduar për Kuvendin e Kosovës aprovimin e 2 emrave. Emrat e rekomanduar nga Komisioni ad-hoc kanë qenë Argjentina Grazhdani dhe Daut Demaku. Mendojmë që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, por edhe në emër të Komisionit ad-hoc, që tanimë nuk është kryetari prezent që e ka udhëhequr këtë Komision, i japim përkrahje emërimit të këtyre 2 kandidatëve. Njëkohësisht, edhe në emër të komisionit parlamentar funksional, si nënkryetar i këtij komisioni, përkrah rekomandimin që ka sjellë Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Dua t'i njoftoj kolegët e nderuar deputetë që Komisioni ad-hoc i ka pasur të gjitha të dhënat për kandidatët dhe mbi bazën e ligjit ka bërë edhe këtë rekomandim, por për momentin, deputetët e tjerë që janë për herë të parë në këtë legjislaturë, si të zgjedhur, nuk i kanë të dhënat për kandidatët që janë përzgjedhur dhe e kuptojmë si një të drejtë të tyre për të kërkuar ndoshta këto të dhëna. Por, megjithatë, mendojmë si komision parlamentar që duhet t'i rekomandojmë Kuvendit aprovimin e këtyre 2 emrave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet plotësisht kandidaturat e propozuara nga Komisioni ad-hoc dhe Komisioni për Media pranë Parlamentit për zonjën Tina Grazhdani dhe zotin Daut Demaku. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Përfaqësuesi i AKR-së foli. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i mbështet 2 kandidaturat të cilat kanë ardhur para Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radhën e ka Grupi Parlamentar i LDD-së, kryetari i Grupit Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet kandidaturat e propozuara në fjalë. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: I mi u načelu podržavamo predlog da se članovi koji su predloženi, podrže. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetët e Grupit Parlamentar të SLS-së, mungojnë.

Deputetë të tjerë nuk janë paraqitë për debat.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Ju njoftoj se në sallë janë 89 deputetë.

Konstatohet se me 78 vota “për”, 1 “kundër” dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për emërimin e anëtarëve të propozuar, zonjën Argjentina Grazhdani dhe zotin Daut Demaku në Këshillin e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Tani kthehemi te pika e katërt e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave**

Qeveria e Kosovës i është drejtuar Kuvendit me kërkesë për procedim dhe miratim të listës së kandidatëve të propozuar për anëtarë të Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave në pajtim me nenin 12 dhe 1 e 2 të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë.

Vendimi i Qeverisë, bashkë me të dhënat biografike të kandidatëve të propozuar, u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Kërkoj nga ministri i Shërbimeve Publike, zoti Arsim Bajrami që ta marrë fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar ministra,

Ministria e Shërbimeve Publike, në kuadrin e përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave ka filluar përgatitjet intensive teknike, profesionale, do të thosha edhe harmonizimet e nevojshme politike, në mënyrë që Kosova, pas pavarësisë së saj, të fillojë të implementojë edhe një proces shumë të rëndësishëm, jo vetëm demokratik, por edhe për zhvillimin ekonomik, regjistrimin e popullsisë, të ekonomive dhe të banesave, një projekt ky shumë i domosdoshëm meqenëse në Kosovë nuk ka pasur një regjistrim valid që nga vitet e 80-ta.

Nevoja e fillimit të këtij procesi është imediate, sepse nga regjistrimi i popullsisë varet shumë edhe strategjia e zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye, ne kemi filluar përgatitjet e gjithanshme profesionale, teknike me Entin e Statistikës të Republikës së Kosovës, me donatorët tanë, me Euro-Statin që është një institucion kompetent në nivel Evropian, në mënyrë që të bëhet e mundur që sivjet, në fund të vitit, të fillohet me implementimin e procesit të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Ky proces do përgatitje të gjithanshme teknike, politike dhe do edhe një klimë të posaçme politike, ku procesi i regjistrimit do të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë të gjithë qytetarët dhe shtetasit e Republikës së Kosovës.

Ne kemi çmuar përpjekjet që janë bërë përpara në këtë drejtim, por kemi intensifikuar në mënyrë shumë të shpejtë dhe të gjithanshme kontaktet me partnerët tanë. Qysh dje kemi pasur një konferencë të madhe ndërkombëtare, ku kemi ftuar përfaqësuesit Euro-Stat-it dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë në mënyrë që të bëjmë intensifikimin e përpjekjeve tona që regjistrimi të jetë i mundur në këtë vit. Në funksion të përgatitjeve intensive ne sot Kuvendit të Kosovës, me miratimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i kemi propozuar Komisionin Qendror i cili do të ketë mandatin që të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe vendimmarrjet politike, të formojë grupet e nevojshme të ekspertëve, të prodhojë dokumentet e nevojshme, mostrat e nevojshme në mënyrë që regjistrimi i popullsisë të bëhet me kriterë valide dhe sipas standardeve më të larta evropiane.

Unë tani po e i lexoj emrat e anëtarëve të propozuar të Komisionit dhe do t'ju lus për mirëkuptim për një ndryshim, sepse ndërkohë kemi bërë një ndryshim.

Për anëtarët e Komisionit Qendror të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave, Kuvendit të Republikës së Kosovës i propozohen këta anëtarë:

- Prof. dr. Rifat Blaku, nga Ministria e Shërbimeve Publike, që do të jetë kryesues i këtij Komisioni;

- Zoti Blerim Latifi, që do të përfaqësojë Zyrën e Kryeministrit,
- Hajdar Korbi, Ministria e Ekonomisë dhe Financave,
- Shaip Hajrizi, Ministria e Kulturës, Rinisë Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente,
- Hakile Gjaferi, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Muzafer Çaka, Agjencioni Kadastral i Kosovës,
- Hysni Thaçi, Enti i Statistikës së Kosovës,
- Rasana Robelt, zyrtare ndërkombëtare në Ministrinë e Shërbimeve Publike,
- Karllota Merkante, zyrtare ndërkombëtare në Entin e Statistikës,
- Nebojsa Azdenković, dhe
- Fikrim Damka.

Përbërja e Komisionit i plotëson nevojat që parashihen me rregullat e komisioneve të tilla, është një përbërje shumetnike, ku kemi edhe një asistencë të ekspertëve ndërkombëtarë.

Duke ju lutur për mirëkuptim për këto ndryshime të vogla teknike, ju propozoj që ta miratoni përbërjen e Komisionit Qendror Zgjedhor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Hapi debatin. Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari i Grupit, Ramë Buja.

RAMË BUJA: Faleminderit, Kryetar!

Ne, si Grup Parlamentar e mbështesim këtë listë të kandidatëve për Komisionin për Regjistrim të Popullatës dhe të Pasurive të Banesave.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar, deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet sigurisht Komisionin për Regjistrimin e Popullatës dhe të Pasurisë. Është një proces i cili ka qenë në pritje, i përgatitur, ka kaluar fazën e regjistrimit testues në disa komuna që ka përfshirë edhe testimin e regjistrimit edhe në vende multietnike dhe në komuna me përbërje të ndryshme etnike nga ne si shumicë.

Kam nevojë për një sqarim të përbërja e Komisionit. Ministri Bajrami paraqiti një përbërje me disa ndryshime të vogla. Meqë procedura kërkon përfaqësimin e ministrive adekuate në komision, a është lëshim teknik që zoti Shpend Tërdeva, zëvendësministër nuk është i përfaqësuar, apo Ministria e Pushtetit Lokal, në këtë Komision? Dhe, një arsytim të vogël për ndryshimet eventuale, a ka të bëjë me kapacitete më të mira, apo ka të bëjë me ndryshime që i keni vlerësuar të domosdoshme. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Urdhëro ministër, sqaroje edhe njëherë!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Unë ju kërkoja mirëkuptim për këto ndryshime të vogla që janë bërë. Dëshiroj të theksoj se përfaqësimi është bërë nga ministrinë, që obligon ligji.

Në fakt, ne i kemi bërë këto ndryshime për shkak të disa kërkesave që i kemi pasur nga disa ministri të tjera. Përndryshe, mund të bëjmë lëvizje. Në qoftë se duhet zëvendësministri i Pushtetit Lokal të jetë, atëherë mund ta zëvendësojmë me zotin Blerim Latifi që është nga Zyra e Kryeministrit. Edhe ashtu, Ministria e Shërbimeve Publike përmes zëvendësministrit do ta përfaqësojë edhe Zyrën e Kryeministrit. Në fakt aty është ndryshimi dhe ndryshimet tjera po më duket janë edhe te heqja e kandidatit të 12-të, sepse në bazë të ligjit Komisioni Qendror për Regjistrimin e Popullsisë i ka gjithsej 11 anëtarë.

KRYETARI: Unë dua ta japë një sqarim. Në propozimin të cilin Qeveria ia ka propozuar Kuvendit për procedim dhe miratim, figuron edhe një përfaqësues, anëtar nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, e cila, si institucion nuk ka të drejtë të propozojë anëtarë, bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave në Kosovë dhe në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/53, përveç nëse ka marrëveshje.

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përsëritet, zoti Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë deputetë,

I bashkohem fjalës së ministrit për rëndësinë që ka çështja e regjistrimit të popullsisë dhe të pasurisë në Kosovë, që nuk është bërë një kohë të gjatë. Ne në Kryesi të Parlamentit, kur e kemi diskutuar këtë pikë për ta futur në rendin e sotëm të ditës, kemi diskutuar pak më gjatë dhe në fakt kemi dhënë edhe një mendim se në këtë Komision duhet të përfshihen edhe institucione relevante që direkt kanë të bëjnë me çështje të regjistrimit. Aty kemi përmendur dy institucione që nuk i pashë që janë përfshirë këtu. Është fjala për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Anëtar i Kryesisë, zoti Hamiti ka pasur propozim konkret, edhe unë kam pasur propozim për Institucionin e Arkivit të Kosovës, një institucion i rëndësishëm që duhet të jetë pjesë e këtij Komisioni krahas ministrive që direkt kanë të bëjnë me këtë punë. Ne e përkrahim këtë përbërje, por me këtë plotësim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, por unë dua t'ua lexoj ligjin!
Neni 12, Komisioni Qendror i Regjistrimit përbëhet nga përfaqësuesit e:

1. Qeverisë së Kosovës,
2. Ministrisë së Shërbimeve Publike,
3. Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave,
4. Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjes Jorezidente,
5. Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
6. Agjencionit të Kadastrit të Kosovës,
7. Entit të Statistikës të Kosovës,
8. Zyrtarit kryesor ndërkombëtarë nga Ministria e Shërbimeve Publike,

9. Zyrtarit ndërkombëtar nga Enti i Statistikës të Kosovës.

Mirëpo, kësaj rregulloreje, këtij ligji i janë shtuar nga shefi i UNMIK-ut edhe dy propozime. Me propozim të Qeverisë, Komisionit Qendror i janë shtuar edhe 2 anëtarë të minoriteteve, do të thotë një përfaqësues të jetë nga minoriteti serb dhe një nga minoritetet e tjera ose joserbe. Gjithsej janë 11 anëtarë. Ky është ligji dhe ne duhet ta respektojmë këtë që është në ligj.

Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të AAK-së. Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se ky është një proces tepër i rëndësishëm. Regjistrimi nuk ka ndodhur për më tepër se një çerek shekulli në Kosovë. Sidoqoftë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk do ta mbështesë këtë listë. Arsyt janë shumë të thjeshta, janë ndërruar emrat sot, nuk i kemi marrë emrat me kohë. Ne e dimë që ministri Bajrami e di pak më mirë se të thotë që është ndryshim teknik, të na ndryshojë emrat në listë të cilët na kanë ardhur vetëm tash. Nuk është ndryshim teknik, është ndryshim substancial. Nuk kemi pasur kohë t'i lexojmë, nuk kemi pasur kohë t'i dimë dhe, nëse thuhet që deputetëve u është shpërndarë lista në këtë datë, duhet prapë përmirësohet, sepse realisht lista u shpërnda tash, para 7 ose 8 minutave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka udhëheqësi i Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për rëndësinë e këtij procesi, pavarësisht që foli mjaft ministri, ne e konsiderojmë që kjo përbërje, kjo strukturë nuk i plotëson kriteret e nevojshme sa kërkon ky proces i rëndësishëm. Prandaj, duke aluduar edhe në konsultimet të cilat kanë ekzistuar në Kryesinë e Kuvendit, në takimin e fundit, dhe në përkrahje të plotë edhe të kërkesës të Grupit Parlamentar të AKR-së që Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës të jetë patjetër pjesë përbërëse e këtij trupi. Ne me këtë përbërje nuk e përkrahim këtë propozim të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Me gjithë respektin, është mirë ta konsultoni ligjin dhe unë jam i obliguar ta mbrojë ligjin dhe ligji nuk e parasheh Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Për Grupi Parlamentar “7+”, fjalën e ka Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Si Grup Parlamentar e mbështesim Komisionin dhe, natyrisht, listën e kandidatëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetët e paraqitur për diskutim. Deputeti, Sabit Rrahmani.

SABIT RRAHMANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kam vërejtje vetëm te përfaqësuesi i minoritetit joserb, i cili e përfaqëson këtë listë. Zoti Kryeministër, a ka qenë dashur që të konsultohen edhe minoritetet e tjera lidhur me përfaqësimin e minoriteteve joserbe në këtë listë, edhe pse ne do ta mbështesim në parim. Me qenë se kemi pasur disa anashkalime të procedurave, kërkoj nga ministri, a ekziston mundësia të shtohet numri i këtij Komisioni që të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve të tjera, duke marrë parasysh që procesi i regjistrimit për ne është shumë i rëndësishëm. A ka ndonjë procedurë e cila mund ta shtojë numrin e këtij Komisioni që të përfshihen të gjithë përfaqësuesit e minoriteteve? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka mundësi, por duhet të ndryshohet ligji. Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju përshëndes të gjithëve që jeni të pranishëm.

Më duket se regjistrimi i popullsisë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për çdo shtet e çdo komunitet. Prandaj, më duket jo e logjikshme që këtu në këtë Komision Qendror të jenë të përfaqësuar vetëm njerëzit nga entet e ndryshme. Këtu duhet të jenë njerëzit që dinë diçka. Nuk po them që nuk dinë edhe këta që janë prej këtyre enteve, por ne kemi ekspertë jashtëzakonisht të afirmuar dhe të aftë, të cilët mund të japin një kontribut shumë të madh në këtë drejtim, sepse me regjistrimin e popullsisë me rezultatet të tij duhet ndryshuar edhe disa ligje, ndoshta. Nuk është e mjaftueshme të përfaqësohet dikush pse i përket këtij ose atij nacionaliteti, ose kësaj ose asaj partie, por duhet në bazë të numrit të popullsisë të ndahen edhe vendet udhëheqëse ose aktivitetet e tjera. Prandaj, po them, këtu duhet të jenë para së gjithash demografët, të cilët merren me këtë lëmi dhe të cilët janë të aftë të japin një kontribut të nevojshëm në këtë rast.

Këtu Akademia e Shkencave duhet të jetë patjetër e përfaqësuar, sepse aty është demografi më i madh që e ka Kosova, akademik Hivzi Islami, i cili duhet ta ketë vendin e vet aty. Ka edhe të tjerë, por ky, po them, është më i afirmuar dhe mund t'i japë një kontribut të nevojshëm këtij aksioni.

Ligji po i kufizua mundësitë, por ligjet shpeshherë edhe mund të ndryshohen për të mirën e përgjithshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Por, ligjet të ndryshohen me kohë. Sot nuk mund ta ndryshojmë ligjin, sepse e kemi propozimin konkret. Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa!

Ja bih pozdravila sve prisutne i Predsedništvo.

Ovako, kada je u pitanju ovaj Zakon o popisu stanovništva, nekretnina, kuća i stanova, pošto je od izuzetne važnosti ovaj Zakon za sve nas, ja dajem konkretan predlog kada je u pitanju članstvo u Komisiji. Pošto smo čuli od predsednika da ima mogućnosti za povećanje članova, ja zahtevam da svaka zajednica koja je prisutna u Ustavnom okviru Kosova, bude član ove zajednice zato što je u pitanju jako izuzetno pitanje od velike

važnosti. Molim da svaka zajednica, kao što je Bošnačka zajednica, zajednica Goranaca, Zajednica Aškalija, kao što smo čuli Roma i oatalih nemaju svoje predstavnike. Mi smo danas gradjani ovog društva Kosova i molim da svaka zajednica ima svog predstavnika. Hvala!

KRYETARI: I lus deputetët që vërtet ta kuptojnë që Ligjin nuk mund ta ndryshojmë sot.

Fjalën e ka Kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne kemi propozuar Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kandidatët janë të propozuar dhe udhëheqës i këtij Komisioni është eksperti, zëvendësministri zoti Rifat Blaku, ekspertë përkatës dhe shumë i përgjegjshëm e me renome ndërkombëtare. Në anën tjetër, ne zhvilluam edhe konsulta për mirëkuptimin e propozimit të zotit Haziri, për spostimin e njërit prej anëtarëve që ishte më herët në listë, dhe në anën tjetër, në emër të Qeverisë, duke respektuar ligjin, por edhe vullnetin dhe përgjegjësinë e botës akademike, gjithashtu, propozoj Hivzi Islamin në të njëjtën kohë, pa të drejtë vote, dhe një përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës.

KRYETARI: Pa drejtë vote mund të bëhen më shumë, por Ligji përcakton numrin e anëtarëve të Komisionit.

Shkojmë me radhë. Fjalën e ka deputeti, anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit, Krasniqi,

Zoti Kryeministër Hashim Thaçi, me ekipin tënd,

Deputetë të nderuar,

Unë, kur e lypa fjalën, ishte pa e marrë këtë listë. Kërkesa ime ishte që, meqë po flasim për respektim ligjesh, ta respektojmë Rregulloren, ta respektojmë Kuvendin, ta respektojmë vetveten.

Ky Komision ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe regjistrimi i popullsisë ka një rëndësi të jashtëzakonshme për Kosovën. Në të gjitha variantet jam njëri nga përkrahësit e mëdhenj që të mos vonohet ndërtimi i Komisionit dhe përgatitjet që të kryhet ky regjistrim. Por, në të njëjtën kohë, si një njeri që i ka për detyrë dhe për qejf procedurat e rregullta, unë kërkoja që këtë listë ta kemi në këtë formë në mënyrë që të mos përpiqemi të mbajmë në mend emra të njerëzve. Mund të jenë shumë të njohur, por ndonjëri edhe nuk është aq i njohur që ta dimë të gjithë emrin dhe mbiemrin e tij, profesionin dhe fuqitë e tij diturore për ta kryer këtë punë.

Në anën tjetër, ne e patëm edhe një ndërhyrje të Kryeministrit Thaçi, i cili i bëri edhe dy propozime me një status të padefinuar, fundi i fundit, por unë them, le të zbatohet ligji pikë për pikë, le të zbatohet rregullorja pikë për pikë dhe ne jemi këtu që, si

Kuvend, të japim shembull për zbatime. Meqë është këtu, dhe unë e kam në dorë një listë që është e panëshkruar, për t'u bërë dokument unë ia ofroj Kryeministrit Thaçi, që ta nënshkruaj, për ta bërë dokument.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

HASHIM THAÇI: Natyrisht, ky Vendim do të nënshkruhet menjëherë pas aprovimit tash. Vendimi do të nënshkruhet dhe ne pajtohemi plotësisht. Mbi të gjitha është respektimi i Ligjit, por ju kërkuat, e ishte edhe vullneti ynë që të kemi përfshirje sa më gjerë akademike, me vlerësimin më të lartë për përkrahje dhe si një proces shumë i rëndësishëm për vendin dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, tash kur jemi shpallur edhe shtet. Kërkuam mirëkuptimin tuaj për një përfaqësues që e përmenda edhe me emër nga Akademia e Shkencave, dhe një përfaqësues nga Universiteti. Në njërin anë ju kërkon që të kemi përfaqësues dhe nga bota akademike, e ky është edhe vullneti ynë, ndërsa në anën tjetër tash dilet kundër këtij propozimi. Ne nuk po kuptojmë.

Zoti Hamiti, Ligji është mbi të gjitha dhe kjo duhet kuptuar një herë e përgjithmonë. Ne si Qeveri do ta respektojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe njëherë po kërkoj nga deputetët që janë paraqitur për diskutim, që diskutimin ta mbështesin në ligj. Ne e kemi miratuar këtë Ligj dhe kur e kemi miratuar Ligjin është dashur të shihet se këtu po mungon Akademia e Shkencave dhe ndonjë institucion tjetër. Atëherë nuk kemi dashur ta shohim, prandaj sot është tepër vonë që po e shohim këtë. Ju lus që debatin ta zhvillojmë konform ligjit që është në fuqi. Fjalën e ka Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Zoti kryesues, përshëndetje!

Përshëndetje për Kryeministrin me Kabinetin dhe për deputetët!

Mua më vjen keq që tash të dal në pozitën e mbrojtësit të Universitetit apo të Akademisë, e gojën e kemi pasur plotë deri më tash se do t'i respektojmë vlerat intelektuale, edhe në fushatën parazgjedhore, edhe në përgjithësi. Më vjen keq, edhe njëherë të them, por ka mundësi të bëhet zgjidhja edhe në harmoni me Ligjin. Në vend të përfaqësuesit të Kryeministrit, që e ka vënë nga zyra e tij, ta vë një përfaqësues nga Akademia e Shkencës ose e Universitetit, një emër të njohur dhe atij nuk po ia ngjesim ne emrin që është përfaqësues i Akademisë, por do të jetë përfaqësues i Kryeministrit, ashtu që të ngrehim nivelin e Komisionit dhe të jemi në harmoni me Ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Meqë kjo çështje po ndërlihet shumë me Zyrën e Kryeministrit, unë e përmenda edhe në fjalën time në fillim. I propozuari nga Zyra e Kryeministrit, tërhiqet në favor të Shpend Tërdevës. Treguam se kemi

mirëkuptim edhe për 2 anëtarë shtesë nga bota akademike dhe një nga bota e Universitetit. Zoti Hamiti besoj se nuk është kundër Hivzi Islamit

(Ndërhyrje nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

Po mirë, edhe me të drejtë vote, edhe me drejtë të flasë, edhe të shkruaj, të ndihmojë, të gjitha.

KRYETARI: Ju lutem, pazaret i leni jashtë Parlamentit. E kemi Ligjin përpara dhe ne jemi të obliguar t'i bëjmë ligjet dhe t'i respektojmë ato.
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar Kryeministër, zëvendës kryeministra, ministra,
Të respektuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Do të kisha filluar me një thënie latine: "Dura leks sed leks". Ligji edhe kur është kuaziaps apo pseudoligj, është ligj dhe obligon. Do të thotë, e mbështes pikëpamjen se duhet ta përfillim ligjin me korrektësi, pa kurrfarë dileme. Mirëpo, pa dyshim është një ligj që kërkon për t'u rishikuar, prandaj do të ishte mirë që ta vëmë në agjendë, i sugjeroj Qeverisë që ta vejë në agjendë për ta rishikuar edhe për ta përmirësuar, një.

Dy, tani e morëm këtë listë, në këtë moment, unë së paku, këtu që jemi ne, kështu që nuk është procedurë bash në rregull. Këtu shkruan se ky është vendimi i Qeverisë, mirëpo vendim i Qeverisë që i jepet Kuvendit të Kosovës për t'u shndërruar në vendim, për t'u konfirmuar, por nuk është i nënshkruar nga Kryeministri i Qeverisë, zotëri Hashim Thaçi. Përderisa nuk është i nënshkruar, nuk mund të ketë vlerë të një akti të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Propozoj, zoti Kryetar, që këta anëtarë që do të konfirmoheshin, të kenë edhe zëvendës, sepse mund të ndodhin situata të paparashikuara. Ky Komision ka rëndësi shumë të madhe dhe për ta pasur komplet, si të themi, kuorumin gjithëherë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, por Ligji nuk e thotë, se unë po e respektoj atë, por Ligji nuk e thotë.
Fjalën e ka Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri Kryetar,
Zotëri Kryeministër, ministra dhe ju deputetë,
Unë desha vetëm të them se për këtë çështje të rëndësishme që është këtu, do më thënë regjistrimi i popullsisë, nuk kanë bërë përgatitje të duhura dhe jo vetëm tash, por edhe në seancën e paradites na sollët në një situatë të palakueshme ne deputetëve. Vijnë në një situatë se nuk dimë a të votojmë për atë e për këtë, sepse nuk sqarohen mirë gjërat.

Ministri nuk është dashur sot ta sjellë listën e t'i bëjë ndryshimet. Në një anë thoni se nuk është në listë, e në anën tjetër bëhen ndryshimet. Kur propozohen ndryshime të tjera,

hyjnë. Propozon Kryeministri hyn, tjetri nuk hyn. Më duket se nuk është mirë kështu të humbim kohë, por duhet të përgatiten mirë gjëra. Edhe aktin është dashur ta marrin më herët, ta lexojmë e ta dimë. Prandaj, mos na sillni kështu, se është puna që vetëm po mbetemi si figura të shahut, a të më qitni mua këtu, a atje, nuk di ku... Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Por, megjithatë ne po debatojmë dhe po diskutojmë. Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
I nderuar Kryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,

Sot me të vërtetë ka qenë vështirë edhe për ne, sepse ne nuk kemi mundur ta marrim vesh se kush e udhëheq Kuvendin e Kosovës, a e udhëheq Qeveria, a Kryesia e Kuvendit? Nuk kemi mundur ta marrim vesh, sepse zëvendëskryeministri çohet e bën një propozim dhe ia zë fjalën në fyt anëtarit të Komisionit, Gani Kocit, dhe ai ulet e nuk di çka të thotë. Prandaj, si duket, si duket këtu, ky propozim që është bërë, është një propozim me vend dhe ne duhet ta bëjmë regjistrimin e popullsisë, por ju lutem juve, më herët të merreni vesh, si koalicion që jeni, për propozimet që i bini, dhe t'i sillni me kohë në procedurat e Kuvendit të Kosovës, kurse ne, nëse i votojmë, i votojmë, nëse jo, jo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
I nderuari zoti Kryeministër,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

E para është se, përveç Ligjit, për suksesin e regjistrimit janë të nevojshëm edhe njerëzit. Meqë informatën e morëm tani, është edhe një vërejtje shumë e dukshme në këtë, thotë data 27 shkurt 2008. Zotëri qeveritarë, mos na mashtroni! Sot është 14 mars 2008. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Opozita e ka këtë rol. Fjalën e ka Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče, premijeru i kelege poslanici,
Ja mislim da bi trebalo da se ovaj predlog vrati i da mi kao parlament dobijemo jedan predlog koji će biti u skladu sa Zakonom, da ne dovodimo poslnaike u nezgodnu situaciju. Pitanje je popisa veoma ozbiljna stvar i ovaj predlog članova Popisne komisije je uradjen na bazi zakona. Mi možemo imati želje i mogućnosti, odnosno da pomognemo i Akademiju i respekt prema Akademiji, prema Universitetu, ali ako nije to u zakonu zacrtano, zaista ne možemo da to promenimo ovom prilikom i svaki potez je kršenje zakona koji je usvojila Skupština, ne u ovom mandatu, nego u prethodnom mandatu.

Pozdravljam nastup predsedika Parlamenta koji danas zaista, kada je u pitanju ovaj predlog, nastupa kao zaštitnik zakona koji su ovde doneti i mislim da će svaki dalji nastavak baciti senku na izbor ove Komisije, koja treba da radi ozbiljan posao, kao što je popis stanovništva, koji na Kosovu nije urađen punih 27. godina. Želimo da imamo Komisiju koja će biti izabrana na osnovu zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputeti Rasim Selmani

RASIM SELMANI: Ju faleminderit zoti Kryetar!

Do të dëshiroja zotin Thaçi, zotin Kryeministër, ta pyesja, tri herë e mori fjalën dhe kishte tri mendime të ndryshme. Herën e parë tha që të respektohet ligji, pra të aprovohet lista që është ofruar nga ana e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Herën e dytë ishte propozimi të futen edhe dy kandidatë, por pa të drejtë vote, do me thënë nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe një nga Arkivi i Kosovës, dhe në herën e tretë, herën e fundit ishte që bën dy kandidatë, por bën edhe me vota.

Unë kisha për ta përkrahur herën e parë, kur zoti Thaçi e mori fjalën. Përkrahet ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka regjistrimi i popullsisë dhe duke pasur parasysh që në këtë komision duhet të ketë vërtet ekspertë, nuk është hera e parë që mund ta bëjmë një ndryshim, natyrisht, duke kërkuar nga PSSP-ja që, me pëlqimin e Kuvendit, ta bëjë këtë ndryshim të ligjit, pasi kemi iks raste që kemi bërë ndryshime në interes të mbarëvajtjes së punëve.

Propozimi i Kryeministrit, mendoj propozimi i fundit, që edhe nga Akademia e Shkencës dhe Universiteti të marrin pjesë, të kalojë përmes një kërkesë që PSSP-ja menjëherë ta bëjë këtë ndryshim dhe të bëjë plotësimin, pasi që edhe më herët e ka bërë plotësimin me dy anëtarë të minoriteteve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ligjet duhet t'i ndryshojmë ne, nëse është puna për t'i ndryshuar. Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Kam përshtypjen se deputetët me diskutimet e tyre më tepër po shkaktojnë konfuzion dhe, për hir të korrektësisë, jo në raport me ne, po në raport edhe me opinionin publik. Konsideroj se do të duhej të jemi pak më serioz në trajtimin e kësaj çështjeje kaq serioze, sepse ka më shumë se një çerek shekulli që popullata e Kosovës nuk është e regjistruar dhe ne do të duhej të jemi sa më azhur në këtë drejtim. Prandaj, vetëm dua të ritheksoj se lista e cila u propozua sot këtu, ka vetëm një ndryshim, i cili ndryshim u tërhoq. Pra, u tërhoq përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, zoti Blerim Latifi, për ta respektuar ligjin për arsye se 11 anëtarë do të duhej të jenë në këtë Komision. Ndërkaq, propozimet e tjera u janë shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve, me përjashtim të propozimit numër 9, që është në listë, do të thotë që është përfaqësues ndërkombëtar. Prandaj, edhe për shkak të korrektësisë në raport me opinionin, sepse mundet të krijohet përshtypja që vërtet kjo listë është shpërndarë sot. Kjo listë është shpërndarë me kohë, bile edhe me një pjesë të CV të kandidatëve të propozuar.

Sa i përket involvimit në procesin e regjistrimit të botës akademike, kjo nuk e përjashton mundësinë që ata të involvohet, por nuk është e thënë që domosdoshmërisht të jenë anëtarë të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Regjia, ia jep fjalën deputetit Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Në radhë dua ta shpreh një pakënaqësi time si deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës me fillimin e seancës së sotme, me një joseriozitet, sepse Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit e përfaqësojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kur ta caktojmë rendin e ditës, dua ta respektojmë dhe duhet të punojmë konform procedurave dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Kërkoj edhe një sjellje institucionale dhe serioze nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse ne jemi deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kjo Qeveri ka dalë nga ky Kuvend.

Sa u takon propozimeve që na i solli ministri i Shërbimeve Publike, unë në këtë listë prej 11 anëtarëve e shoh vetëm një ekspert. Ky është profesor Rifat Blaku, që është një demograf i thirrur, ndërsa emrat e tjerë, me përjashtime shumë të vogla, janë emra anonim që nuk janë dëgjuar që kanë një ekspertizë dhe ato CV të tyre nuk garantojnë një menaxhim serioz të një projekti mbase më të rëndësishmin për Kosovën, tani si shtet i pavarur. I sugjeroj Kryeministrit dhe ministrit që konform procedurave të respektohet Ligji. 11 anëtarë, në rregull, t'i përfshijmë të gjithë. Ky propozim le të na vijë në seancën e ardhshme, do ta votojmë pa asnjë problem edhe si opozitë, mirëpo të jetë një komision profesional i thirrur, sepse kemi të bëjmë me një vakum 27 vjeçar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë e di që nganjëherë edhe Kuvendi mund të shndërrohet në teatër...

KRYETARI: Të lutem, kryesues jo, unë jam votuar Kryetar i Parlamentit.

GANI KOCI: Kërkoj falje. Ju faleminderit, zoti kryetar, Jakup Krasniqi, se mendova mos e kam Xhavit Halitin përpara, prandaj kështu ishte një inercion.

Unë e kuptoj që Kuvendi, si institucion shumë serioz, nganjëherë shndërrohet në teatër. Në teatër luhen edhe vepra shumë serioze, por nuk e kuptoj që Kuvendi të shndërrohet në teatër të kukullave. Pikërisht sot më ngjanë që ky institucion është shndërruar në teatër të kukullave.

KRYETARI: Ne nuk jemi duke folur për teatër, por jemi duke folur për propozim...

GANI KOCI: Po, për Kuvendin jam duke folur unë dhe nuk do të dëshiroja që herëve të tjera të ndodhë kjo. Në qoftë se pas çdo propozimi na dalin ide të ndryshimit të ligjeve dhe t'i përshtatim ligjet sipas njerëzve, unë mendoj se me këtë nuk do të shkojmë askund, absolutisht.

Në radhë të parë, ky Kuvend duhet të respektojë Ligjin, që të kërkojë pastaj prej të tjerëve ta respektojnë këtë. Respekt për botën akademike, për botën e Universitetit, për shoqërinë civile sepse të gjithë kanë mundur ta japin kontributin e vet në një formë ose tjetër edhe në këtë çështje, por ligjin ne sot nuk mund ta ndryshojmë, sepse ka një procedurë për ndryshim të ligjit. Të gjitha propozimet mund të shkojnë, të hiqet një nga këto propozime dhe të vendoset një tjetër, dhe nuk mund të bëhet shtimi as në trembëdhjetë, as në katërbëdhjetë, dhe as në dhjetë, por në njëmbëdhjetë anëtarë, qysh e thotë edhe ligji. Ligji e thotë se këta janë të gjithë me të drejta dhe kompetenca të tyre që i kanë dhe ne duhet të veprojmë në këtë mënyrë. Unë jam shumë i bindur që edhe akademik Hivzi Islami do t'i kontribuonte këtij komisioni që është shumë i rëndësishëm dhe, hajde urdhëroni, le të dalë dikush me propozim, le të thotë të hiqet ky dhe të vijë ky tjetri në emër të Qeverisë, siç doli këtu, dhe ta mbyllim këtë problematikë.

Nuk konsideroj që sot ne duhet merremi me atë se a ta ndryshojmë ligjin, a mos ta ndryshojmë ligjin për të bërë qejfet dhe tekat e individëve këtu dhe të deputetëve ose të propozuesve në këtë çështje.

KRYETARI: Ju faleminderit,
Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBARAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Zoti Kryeministër,
Të nderuar kolegë,

Vërtet, në emër të rëndësisë që kanë disa çështje, ne po i shkelim parimet edhe ligjet. Kështu na ka ndodhur edhe në zgjedhjen e Qeverisë, kështu edhe në miratimin e buxhetit. Po kam frikë se kjo nuk do të ketë përfundim. Ky Kuvend, sikur e thanë edhe shumë

kolegë të tjerë, përpos që ka për obligim të nxjerre ligjet, ka për obligim që t'i respektojë në radhë të parë ato.

Në të vërtetë, do t'ia shtroj një pyetje Qeverisë, si propozuese e kësaj liste. A i plotëson kjo listë kriteret profesionale, lista emërore, kriteret profesionale për rëndësinë që ka çështja e regjistrimit dhe ky komision në përgjegjësi? Nëse po, atëherë unë kujtoj se nuk do të duhej të humbim kohë në shqyrtime të mëtutjeshme. Kësaj liste, ashtu siç e përcakton ligji, nuk mund t'i shtohen as edhe dy, as edhe një njeri tjetër, sepse duhet të respektojmë ligjin. Ju faleminderit!

Fjalën e ka Ministri Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Unë po i kuptoj shqetësimet tuaja shumë sinqerisht, por dua ta shpjegoj një gjë. Komisioni Qendror më tepër është një komision politik, për të cilin e ka përcaktuar vetë Rregullorja përbërjen. Nuk mund të flasim tash, përbërja është e përcaktuar, cilat ministri marrin pjesë. Por, dëshiroj të theksoj se ky Komision nuk do ta zbatojë regjistrimin, ky i udhëheq politikat e regjistrimit, caktimin e datave. Ky Komision do të formojë komisione shumë respektive të ekspertëve, të cilat kanë për të qenë bartëse të procesit të regjistrimit dhe aty kanë për t'u përfshirë ekspertët më të mirë demografikë.

Unë jam i sigurt që ky komision ka për t'i pasur së paku 20 deri 30 demografë dhe ekspertë, edhe vendorë, edhe ndërkombëtarë, që janë njohës të regjistrimit të popullsisë.

Ky më tepër ka për t'u marrë me politikat e regjistrimit, datat, finesat, por jo edhe me çështje ekspertize. Kryeministri tregoi një vullnet jashtëzakonisht të mirë duke propozuar që Akademia e Shkencave, Arkivi i Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës të jenë konsulentë të komisionit, edhe në nivelin politik, por këto tri institucione kanë për t'u përfshirë sidomos në nivelin e ekspertëve dhe me disa akademikë, disa profesorë të Fakultetit Ekonomik, disa ekspertë tjerë kanë për të qenë bartës të operacioneve të regjistrimit të popullsisë. Tani nuk guxojmë që në emër të kërkesave, për aspektin profesional ta bëjmë shtyrjen e ligjit, sepse derisa nuk ndryshohet ligji, ai taksativisht e ka përcaktuar strukturën.

Të vetmin ndryshim që ne e kërkuam, ishte që Zyra e Kryeministrit të mos përfaqësohet nga një përfaqësues, por të hyjë zëvendësministri i Pushtetit Lokal.

Përsëri, edhe lista e ekspertëve kur të formohet, ajo do t'i prezantohet Qeverisë dhe ajo listë do të jetë bartëse operative dhe operacionale dhe profesionale e procesit të regjistrimit. Assesi nuk duhet të krijohet përshtypja se dikush po do të anashkalojë rolin e institucioneve akademike profesionale dhe shkencore në procesin e regjistrimit.

Ministria e Shërbimeve Publike dhe Qeveria janë plotësisht të interesuara që ky operacion të zhvillohet me kritere më të larta profesionale, sepse unë vlerësoj se do të jetë një nga projektet më të rëndësishme pas pavarësisë së Kosovës, dhe ne jo vetëm që do të angazhojmë të gjithë ekspertët që merren, por kemi nevojë të angazhojmë edhe

ekspertë të jashtëm dhe, t'ju them të drejtën, jemi në rrugë, në kontakt të mirë që të sigurojmë asistencën e tyre, në mënyrë që regjistrimi të bëhet me kritere dhe standarde evropiane, sepse ne dëshirojmë që regjistrimi të njihet menjëherë dhe ai të jetë çelës dhe një nga standardet ndoshta edhe për integrimet tona evropiane. Ju e dini se edhe Pakoja e Ahtisarit ka kërkuar që në një periudhë të përshtatshme të bëhet regjistrimi i popullsisë, i cili do të jetë parakusht.

Edhe njëherë ju lus që të pranoni faljet tona për këtë rishikim teknik që është bërë sot dhe ta votoni këtë Komision. Dua t'ju bindi që do të përfshihen të gjithë ekspertët e Akademisë së Shkencave, të universiteteve dhe të institucioneve të tjera në zbatimin e këtij projekti të rëndësishëm për Kosovën.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ: Ju faleminderit, Kryetar!
Realisht, krejt çka desha të them, e tha kolegu im, deputeti Gani Koci. Unë vetëm dua të shtoj se pajtohem plotësisht që sot Qeveria me të vërtetë ka tentuar që këtë Kuvend ta kthejë në teatër kukullash dhe ka treguar se kjo Qeveri është shumë joserioze që të merret me një çështje kaq serioze për vendin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Është mirë t'u ikim kualifikimeve.
Kanë përfunduar diskutimet lidhur me ndryshimet e propozuara.
Në vend të Blerim Latifit, është zëvendësministri i Pushtetit Lokal, zoti Shpend Tërdeva. Me këtë ndryshim dhe me sqarimet që i dhanë, të cilat mendoj se janë të mjaftueshme, e hedh në votim propozimin. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Tani në sallë janë 91 deputetë.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota "për", 29 "kundër" dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi listën e kandidatëve të propozuar për anëtarë të Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Ju falënderim! Tani propozoj 15 minuta pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës për sot:

- Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës

Në pajtim me nenin 18, alineja 2 të Rregullores së UNMIK-ut, Numër 2006/47, për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës i është drejtuar Kuvendit me Propozimvendim për zgjedhjen e drejtorit menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës.

Propozimvendimi i Qeverisë, bashkë me të dhënat biografike të kandidatit të propozuar, iu është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin për Ekonomi dhe Financa, të marrë fjalën për prezantimin e Propozimvendimit.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Në bazë të nenit 9.3 pika 16 të Rregullores së UNMIK-ut, Numër 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese të Përkohshme të Kosovës dhe të nenit 1 të kësaj Rregulloreje, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, si dhe të nenit 4 pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës dhe pas konsultimeve të bëra e rekomandimeve të fuqishme të institucioneve financiare ndërkombëtare, siç është Fondi Ndërkombëtar Monetar, Banka Botërore dhe institucionet e tjera të rëndësishme me prezencë në Kosovë, e që janë partnerë tanë dhe ndihmë për të arritur në këtë gjendje, si dhe në bazë të frymës së kosovarizimit të këtij institucioni, që konsideroj është shumë i rëndësishëm në këtë moment pas definimit të statusit të Kosovës, pra pas shpalljes së Republikës,

Kuvendit të Kosovës Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2008, i propozon zotin Hashim Rexhepi, për drejtor menaxhues të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës.

Të gjitha dokumentet janë dhe CV e tij i janë bashkëngjitur materialeve që i keni dhe ju thërras, në emër të Qeverisë, që ta mbështetni propozimin e Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kryetari i Grupit, Ramë Buja.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I respektuar zoti Kryeministër dhe zëvendëskryeministra,

Ne, si Grup Parlamentar mbështesim propozimin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nëse më lejon, do ta bëj edhe një korrigjim të vogël. Jam zëvendësshef i Grupit dhe përfaqësoj gjithmonë Grupin Parlamentar në mungesë apo me përgjegjësi të plotë, nëse shefi ynë i Grupit Parlamentar është apo nuk është këtu. Sidoqoftë, faleminderit shumë! E di që, si strukturë, ju mungon.

Grupi Parlamentar i LDK-së do të marrë pjesë në votim dhe sigurisht se ne e kemi diskutuar brenda Grupit tonë dhe kemi respektuar rekomandimin e Qeverisë dhe në konsultime dhe me Presidentin e vendit, i cili do të ketë edhe obligime kushtetuese pasi që Kushtetuta të miratohet. Për ne ka qenë ndoshta pak, jo e ngutshme, por në kohën që e kemi pritur, ka ndodhur një zhvillim çfarë ka ndodhur dhe, si i tillë, ne do të marrim si Grup Parlamentar në votim dhe besojmë se do të zgjidhet kjo çështje brenda kësaj dite. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re do të marrë pjesë në votim dhe kërkojmë që votimi të jetë i fshehtë në mbështetje të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës. Aleanca e Re nuk ka një qëndrim të prerë sa i përket kësaj çështjeje, por kërkojmë që votimi të jetë i fshehtë, në mbështetje pra të Rregullores së Punës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe pse ky propozim nuk është propozim i Qeverisë, megjithatë, ky është një propozim i mirë, prandaj Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet kandidaturën e zotit Hashim Rexhepi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kryetari Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Fatmirësisht, po fillojmë pas një pauze bukur të gjatë dhe pa arsyetim, mirëpo ajo çka Lidhja Demokratike e Dardanisë, gjegjësisht Grupi Parlamentar i saj konsideron se për këtë proces është shumë e rëndësishme që të inkurajohet edhe më tej sistemi bankar në vend, për çka ka vlerësim pozitiv. Ndërsa, sa i përket kësaj procedure, ne jemi për mbështetje të Rregullores së Punës të Kuvendit, ndërsa deputetët nga radha e Lidhjes Demokratike të Dardanisë, gjegjësisht Grupit të saj parlamentar, do të marrin pjesë në votim, që është njëkohësisht edhe obligim i çdo deputeti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar i Parlamentit!

Ne, Grupi “7+”, do ta mbështesim propozimin.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, mungon.

Tani kemi në radhë deputetët. Për fjalë është lajmëruar deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kryeministër, mendoj që për këtë propozim, që ia keni bërë Parlamentit për emërimin e Drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar, është dashur të merrni informata më të mëdha, të bëni konsultime me njerëz të profesionit që fatmirësisht në Kosovë ka mjaft – financier e bankier të mirë. Është bërë një propozim për një njeri, për të cilin nuk dua të flas për karrierën e tij politike, as kombëtare, as profesionale sepse të gjithat i mungojnë.

Ju, të nderuar deputetë, keni marrë një letër publike, një letër e cila është dashur sigurisht t'i shkojë edhe Agjencionit Antikorrupsion, edhe Kryeprokurorit, edhe gjykatës, të cilën unë nuk do ta kisha lexuar për arsye se ka etiketime që një deputet nuk duhet t'i flasë ato fjalë, por që përmendet individi si një embrion i së keqes, një sinonim i shkatërrimit, abuzimit, keqpërdorimit, të korrupsionit dhe të përfitimeve personale nga sistemi financiar.

Kjo është letra që iu është dërguar të gjithë deputetëve dhe konsideroj se e keni në e-mail dhe është mirë ta lexoni, nga Çlirim Kosova, me adresë të plotë.

Ndërsa, unë do t'i kisha thënë dy-tri fjalë lidhur me kandidatin e propozuar, zoti Kryeministër. Personi në fjalë është zëvendësudrejtor për mbikëqyrje i cili gjatë mandatit të tij, për shkak të kujdesit apo pa kujdesit, kanë falimentuar dy kompani të sigurimit dhe një bankë dhe për çka, personi në fjalë, është nën hetime të Agjencionit Antikorrupsion.

Kjo e dhënë ndoshta është jo për ju zoti Kryeministër, por për zëvendësin Kuçi, i cili, me këmbëngulësi dëshiron që të çrrënjosë keqpërdorimet në institucionet tona dhe një emërim i tillë konsideroj se nuk i bën nder as Qeverisë e as Parlamentit, në veçanti kur dihet se një raport i Fondit Monetar Ndërkombëtar, që është dhënë, nuk është vënë të trajtohet asnjëherë në Bordin e Autoritetit Qendror Bankar dhe asnjëherë nuk është bërë auditimi në këtë institucion. Ndërsa, për personin në fjalë, jo vetëm thashetheme, por ka edhe argumente që tregojnë se letra e dërguar nga zoti Çlirim Kosova përmban të vërtetën. Pasuria e tij, pas luftës, është shumë e madhe dhe shumë e dyshimtë dhe kjo nuk i bën nder Kuvendit të votojë një person, të cilin ju e keni propozuar. Besoj se do të ishte mirë që ju edhe njëherë ta shqyrtoni këtë propozim dhe të gjeni në Kosovë njerëz të cilët dinë ta bëjnë këtë punë dhe që janë autoritativ dhe që janë kombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit zoti Kryetar!

Unë e kam një vërejtje të vogël. Sot mu ndërpre fjala, të tjerëve iu lejua që ta japin argumentin. Mua, mu atëherë kur dëshiroja ta bëja poentën time, ma morët fjalën dhe mendoj se nuk është korrekte për dikë të jesh “nënë” e për dikë “njerë”, ndonëse të njëjtën pyetje do ta bëjë edhe për seancën tjetër, në mos do të vjen edhe interpelanca, por edhe në mediat e shkruara me ministren e Energjetikës e të Minierës, sepse nuk e mora përgjigjen. Sidoqoftë, t'i kthehem i kësaj pyetje.

Unë çka desha të them, shumë sende i tha i nderuari deputet, zoti Osmani. Unë, duke pasur parasysh se me Projektkushtetutën tonë Autoriteti Bankar do të na bëhet bankë qendrore, mendoj se kandidati i propozuar nuk do t'i bëjë nder, jo vetëm për shkak të dyshimeve, të aligacioneve të cilat kanë fakte të qëndrueshme dhe është çështje tjetër që sistemi antikorrupsion nuk është implementuar dhe nuk është funksionalizuar ashtu sikur që është dashur të jetë. Mirëpo, duke pasur parasysh, postin për të cilin flasim dhe CV e kandidatit, mendoj se, madje, as nuk është dashur të sillet këtu. Unë do t'ia rikujtoja Qeverisë se “muaji i mjaltit” ka kaluar e tash kemi çështje shumë të rëndësishme dhe konkrete, e kjo është një nga konkretet. Unë jam i bindur se për këtë post ka njerëz të aftë në Kosovë, njerëz profesionalistë, njerëz me CV adekuate. Ky zotëria këtu na ka pru një CV që s'ka asgjë tjetër përveç “workshopeve”, domethënë punëtorive. Tenton të bëhet president i bankës qendrore, që është guvernator. Mendoj se komenti im i mëtutjeshëm nuk është i nevojshëm. Të deklarojem se assesi nuk e votoj këtë njeri! Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kam respekt për qëndrimin tuaj. Unë po kërkoj edhe një herë falje dhe po kërkoj nga deputetët dhe ministrat që, kur është fjala për pyetje dhe përgjigje – ta respektojnë Rregulloren. Përndryshe, kërkoj falje që iu kam dhënë përparësi disa të tjerëve, por më nuk do ta kenë dhe mund ta bëjnë vetëm nëse e ndërrojnë Rregulloren e Punës së Kuvendit. Për fjalë është paraqitur deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Neve sot para vetes kemi një propozim, që kushtimisht ministri i Ekonomisë dhe Financave, tha se është propozim i Qeverisë, ndërkaq nga deputetët thuhet se nuk është propozim dhe qëndrim i Qeverisë. Kam frikën mos po na del nga institucionet paralele të ndryshme që vijnë nga struktura të huaja ky propozim. Qëndrimi i Grupit tonë parlamentar thamë se nuk kemi një qëndrim adekuat lidhur me procesin, por do të marrim pjesë në votim, kështu që në faqet tona të Internetit të të gjithë deputetëve kanë kapluar diçka që të kaluarën e personit në fjalë, të cilin unë nuk e njoh personalisht, e bëjnë shumë të dyshimtë, edhe tashmen, po edhe formën e organizimit të tij që është në sistemin, sistemin ekonomik dhe financiar të Kosovës. Kështu, mbështes propozimin e shefit tonë të Grupit Parlamentar që votimi, edhe në qoftë se kalon në votim, të bëhet me vota të fshehta për shkak se kemi të bëjmë me individin. Ky është edhe qëndrimi im personal, mirëpo, më brengos ai fakt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Me gjithë respektin, mendoj që deputetët nuk mund të udhëhiqen nga letrat anonime që mund të vijnë, edhe pse mund të jenë të vërteta.

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri Kryetar i Kuvendit,

E nderuar Qeveri,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Apriori edhe parimisht do të isha angazhuar kurdoherë që personat të cilët kanë ushtruar funksione publike në sistemin monist, vetëm në qoftë se janë të pazëvendësuar, ndryshe të mos bëhen prapë funksionarë.

Ju lutem, zotëri Kryetar i Kuvendit të Kosovës, sot ne kemi shumë funksionarë publikë, të cilët nuk kanë vepruar sipas ligjit, por sipas qëndrimeve të partisë politike pushtetare, kemi prokurorë publikë, kemi gjykatës që kanë gjykuar deliktet verbale, janë funksionarë, kemi funksionarë të lartë nga Qeveria e poshtë. Ju lutem, kjo është çështje tepër serioze. Unë nuk aludoj, si të them, konkretisht nuk kam të dhëna, kam dëgjuar, por të dhëna nuk kam, flas si jurist. Mirëpo, parimisht, ju lutem, kjo është çështje kruciale.

Sot, për fatin më të mirë, në Kosovë ka ekonomistë shumë të mirë, të njohur madje edhe ndërkombëtarisht, që kanë eksperiencë shumë të çmuara. Është fjala për një institucion tepër të rëndësishëm. Nuk ka sistem ekonomik, si të them, pa një konsolidim të institucioneve çfarë do të ishte Banka Qendrore, banka e shtetit etj., etj. Prandaj, ju lutem, ky është mirë që të jetë një qëndrim, një qëndrim parimor. Për kaq unë angazhohem. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Një sqarim. Votohet për drejtorin menaxhues, e jo për guvernatorin e Bankës së Kosovës.

Driton, merre fjalën! Urdhëro!

DRITON TALI: Shumë shkurt. Unë jam koshient, e kam parasysh se strukturën menaxheriale ende nuk na e ka dhënë Autoriteti Bankar me shndërrimin e saj në Bankë Qendrore, por, sipas të gjitha gjasave, ajo do ta përcjellë modelin e Bankës Qendrore Evropiane - Bundes Bankës, që është e edhe sot. Do me thënë, personin të cilin sot e emërojmë për drejtor menaxhues, ai do të jetë president i Bankës Qendrore të Kosovës, do të thotë, nga Banka Qendrore dhe bankat e tjera njihet si guvernator. Pra, po e votojmë Ttrichet e Bankës Qendrore të Kosovës, ose po e votojmë këtë për një dy-tre muaj derisa të aprovohet Kushtetuta. Na tregoni kohën për sa? Përndryshe, guvernatorin e bankës, me gjithë nderimet, zoti Kryetar, jemi kah e votojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe unë po shpresoj se kur të bëhet Kushtetuta, do të bëhen edhe ndryshime të reja, e të tjera.

Fjalën e ka deputeti Rrustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne sot kemi një propozim për një vend shumë të rëndësishëm. Unë po e lexoj biografinë e tij, ajo është e mjaftueshme. Nuk e njoh personin, por qenka njeri që tashmë 30 vjet punon në funksione të ndryshme. Mirë shumë, por pasi që është vendi aq i rëndësishëm, unë propozoj që të vijnë më shumë propozime, që ne të kemi mundësi të zgjedhim, për një, dy, tre apo më shumë kandidatë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nuk ka më deputetë të paraqitur për debat. E hedhë në votim vendimin e propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Në sallë janë 87 deputetë.

Konstatohet se me 49 vota “për”, 14 vota “kundër”, 13 abstenime, Kuvendi miratoi propozimin e Qeverisë për emërimin e zotit Hashim Rexhepi, drejtor menaxhues të Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës.

Me këtë votim, ne po e përfundojmë seancën e sotme.

Mirpafshim, në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës